

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7600 E mërkurë 25 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Gati një muaj më parë, fill pas vendimit mbi shtyrjen për vitin e ardhshëm të negociatave të anëtarësimit në BE bëri përshtypje një bashkëbisedim ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Diplomacia parlamentare, jetike për negociatat



Opinion i Ditës

Tatimorët tanë zgjodhën pikun e sezonit veror për të vendosur autoritetin e shtetit dhe forcën e ligjeve tona fiskale mbi një aktivitet që në pak më shumë ...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Mësymja fiskale në bregdet



Dyshimi: Flakët u vunë nga grabitësit

## Apokalipsi zjarri në Greqi, 76 të vdekur. Mes tyre 3 shqiptarë të plagosur, 2 fëmijë

Rreth 500 të plagosur e të asfiksur nga zjarri në Athinë. Tsipras shpall 3 ditë zie

Brenda 36 orëve gjithçka është shkrymbuar rreth Athinës, kryeqytetit grek. 76 të vdekur, numri i të cilëve pritet të rritet orë pas ore, 1500 shtëpi të djegur dhe më shumë se 500 të plagosur sipas Kryqit të Kuq është bilanci i bërë nga mediat ndërkombëtare për ndodhinë që po quhet apokalipsi në Greqi. Nuk dihet ekzaktesisht si ndodhi ...  
Në faqen 2-3

## PROCEDURA SI DO TE LEGALIZOHEN SHTEPITE ME MUNGESË DOKUMENTACIONI

# NDERTIMET PARA '91, JA FORMULARI I LEGALIZIMIT

60 mijë ndërtime në të gjithë vendin do të pajisen me tapi. Aplikantët duhet të paraqiten në zyrat e ALUIZNI-t. Trualli falas deri në 300 metra katrorë



(Në foto) Formulari i legalizimit

REPLIKAT PS-PD

Gjykatat "bosh", Rama: Më mirë është se djalli brenda. Basha: Kryeshejtan

Në faqen 5

MESAZHI

SHBA: Bllokimi i "Magjistraturës", dështim i partive në parlament

Në faqen 4

ISH-PRONARET

Dosjet e '97-'98, si aplikohet për të marrë paratë e kompensimit

Në faqen 11

"SUMMER PAGES"

Rudina Dembaçaj: Sfidat e mia si timoniere në punë dhe në familje

Suplement

KONFIRMUOHET NË DETYRE



Kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori kalon me sukses vetingun


Në faqen 9

Krimi në Vlorë/ Nënë e bir u vranë dhe më pas u dogjën në shtëpi, familja: Na thanë u dogj me bombul

## "Nusja u bëri petulla me ilaç gjumi dhe i vrau"

Denoncimi/ Vajzat e familjes Hoxhallari akuzojnë gruan e vëllait dhe të dashurin

TIRANË. Ngjarja tragjike e 22 janarit të këtij viti në lagjen "1 Maji" të Vlorës, ku nënë e bir u vranë dhe më pas u dogjën në banesën e tyre nga nusja e shtëpisë është bërë dhe pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" në "News 24". Viktimat ishin Salkie Hoxhallari,



73 vjeçe dhe i biri, Olsi 43 vjeç, ndërsa ekspertiza tregoi se djali ishte goditur me sëpatë në kokë, ndërsa e moshuara ishte mbytur me tel në gjumë. Për ngjarjen në fjalë u arrestua nusja, Hysnie Hoxhallari dhe Kasem Pirjasi ...  
Në faqen 9

## TRAGJEDIA NE GREQI

### BILANCI



#### ILIR META

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i ka dërguar një mesazh ngushëllimi homologut grek Prokopis Pavlopoulos, pas zjarreve që kanë përfshirë periferinë e Athinës, ku deri tani numri i viktimave ka shkuar në 76. Meta shprehet i tronditur. "Jam shumë i tronditur nga viktimat në njerëz dhe i shpreh ngushëllimet më të ndjera familjarëve e të dashurve të tyre. Të lënduarve i uroj shërim sa më të shpejtë", shkruan Meta.



#### GRAMOZ RUÇI

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi i ka dërguar një letër ngushëllimi homologut grek, Nikos Voutsis. Në letrën drejtuar kryeparlamentarit grek, Ruçi shpreh ngushëllimet e tij. "Kurajo popullit mik dhe fqinj grek. Urojmë ta kaloni sa më shpejt situatën e rëndë. Të gjithë shqiptarët janë pranë popullit grek në këto çaste të rënda. Dhimbje, solidaritet dhe dashuri për familjet greke" është shprehur Ruçi.



#### LULZIM BASHA

"Lutemi që drama të ndalet këtu e të mos rritet më shumë! Qeveria shqiptare duhet të ofrojë menjëherë çdo ndihmë të mundshme në solidaritet me fqinjët tanë, por edhe në shenjë përgjegjësie ndaj bashkqytetarëve tanë në Greqi! Në këto orë të vështira mendimet dhe lutjet e mia janë për të mbijetuarit, të lënduarit dhe të afërmit e tyre", shkruan kryetari i PD-së.



Mati tërësisht i djegur

Zjarri përfshin periferitë e Athinës, mediat: I qëllimshëm

# Tragjedi në Greqi, vdesin në flakë 76 vetë, plagosen 500

Kryeministri shpall 3 ditë zi për ngjarjen e kobshme

Brenda 36 orëve gjithë ka është shkrymbuar rreth Athinës, kryeqytetit grek. 76 të vdekur, numri i të cilëve pritet të rritet orë pas ore, 1500 shtëpi të djegura dhe më shumë se 500 të plagosur sipas Kryeqytetit të Kuq është bilanci i bërë nga mediat ndërkombëtare për ndodhinë që po quhet apokaliptike në Greqi. Nuk dihet ekzaktesisht si ndodhi edhe pse raportohet se disa grabitës shtëpish për të çorientuar banorët kanë vënë një zjarr të qëllimshëm në Atika zonë rreth 30 kilometra larg kryeqytetit, por hapja e zjarrit në 15 vatra i kanë bërë të gjithë të mos kenë një përgjigje të saktë. Temperatura e lartë dhe era me shpejtësi të madhe, bëri që zjarri të përhapet shumë shpejt në pyllin e pishave që rrethojnë Athinën. Atika vazhdon të jetë nën zjarr e komuniteti ndërkombëtar i ka shkuar në ndihmë Greqisë për fikjen e zjarrit. "Janë djegur pyje njëri pas tjetrit dhe kjo do të thotë që është e vështirë të përcaktosh shkakun fillestar", thonë për "Il fatto quotidiano" zjarfikësit grekë. Jorgos Kapakis, shefi i emergjencave civile shprehet për një situatë të tmerrshme e deri diku mezi të përballueshme. Ajo çka ndodhi tashmë mbi 36 orë pas zjarrit masiv mund të përshkruhet si luftë ndër vete. Qindra qytetarë të Atikës e zonave përreth, duke parë flakët që përpërin gjithçka kanë hipur në makina e të tjerë kanë marrë rrugët për të dalë në ndonjë vend më të hapur. Por pje-



#### TMERR NË FAMILJE

Mes fëmijëve të vegjël që humbën jetën si pasojë e zjarreve që pushtuan periferinë e Athinës, është dhe historia e trishtë e dy vogëlushëve, motër e vëlla. Bëhet fjalë për ish-çiklisten e AEK, Evita Fytrou, 14 vjeçe, e cila u gjet e vdekur në det. Vetëm pas disa orësh kërkime u arrit që të gjendeshin edhe babai edhe vëllai i saj. Gregory Fitrous, 54 vjeç dhe Andreas Fitrous, 11 vjeç, dhe ky i fundit një çiklist.



sa më e madhe e viktimave është gjetur pikërisht në rrugë e automjete.

#### ZHDUKET MATI

Shtëpia e nënës me dy fëmijë e gjetur e shkrymbuar duke mbrojtur të vegjëlit e saj, duket e paprekur nga flakët. Gazetari i 'Alfa tv' në Athinë referuar fqinjëve thotë se gruaja duke parë zjarrin të përpinte çfarë dulte përpara mori fëmijët dhe vraoi drejt rrugës kryesore. Por fatkeqësisht

nuk mundi t'ia dalë të shpëtojë të vegjëlit dhe veten. Ajo u gjet e shkrymbuar në rrugë të madhe me dy fëmijë e saj ndërsa shtëpia nuk u prek nga flakët. Ngjarja ndodhi në Mati një fshat tashmë i karbonizuar. Kryeqytetasi grek e shfrytëzoni fshatin turistik buzë detit për shtëpi verore e kishte shumë kampe fëmijësh në të. Sipas raportimeve Mati është një nga zonat ku regjistrohen më shumë vik-

tima. Vetëm në një vend pranë një restoranti në Mati të Atikës janë gjetur 26 trupa njerëzish të djegur, midis tyre edhe fëmijë, ndërsa 150 persona ndodhen në spital, 15 prej të cilëve në gjendje të rëndë për jetën. Kryeministri grek Tsipras ka shpallur tri ditë zie për ngjarjen e rëndë që përfshiu Greqinë. Një situatë e ngjashme ka ndodhur në vitin 2008 në Greqi ku humbën jetën 80 njerëz.



#### ALEXIS TSIPRAS

Nuk ka fjalë për të përshkruar ndjenjat e të gjithëve në momente të tilla. Vendi jeton një tragjedi të patreguar më parë, pasi janë humbur dhjetëra jetë njerëzish dhe kjo është e padurueshme për të gjithë. Më shumë për familjet që humbën të dashurit e tyre, por edhe për ata prej nesh që janë në pozita përgjegjësie. Ne nuk duhet të lejojmë që zija të na mposhtë, për shkak se këto kohë orë luftarake, uniteti, guximi dhe mbi të gjitha solidariteti...



Ambasada shqiptare në Athinë ka konfirmuar plagosjen e tre shtetasve shqiptarë, si pasojë e zjarreve që përfshinë shtetin fqinj. Ambasada e RSh-së në Athinë njofton se pas verifikimeve të kryera në terren në të gjitha spitalet në zonën e Athinës, si dhe nga burimet zyrtare të Emergjencave Civile, rezultoi se përveç rastit të qytetares shqiptare në spitalin Evangelismos për të cilën u njoftua në mesditën e djeshme, janë dhe dy fëmijë nga e njëjta familje, të moshës 10 dhe 13 vjeç nga Fieri, të shtruar në spitalin pediatrik Agia Sofia, në gjendje të mirë shëndetësore. Ndërkaq ambasadorja shqiptare në Greqi thotë se janë duke ndjekur minute pas minute ngjarjen tragjike dhe janë të gatshëm për t'i ardhur në ndihmë familjeve shqiptare në këtë zonë.

## "S'bëhet ende fjalë për viktima nga Shqipëria"

### Ambasada shqiptare në Athinë: Kemi evidentuar tre të plagosur



Flasin shqiptarët në Atika e zonat përreth: Çfarë ndodhi...

# "Nuk e dimë si shpëtuan të gjallë, zjarri përpiu gjithçka"

Jani: Ende nuhas trupa të karbonizuar, ishte tmerr

Ishin momente tmerr. Nuk e dimë si jemi ende gjallë. Zjarri shpërndaj me tërbim duke përpiqur çdo gjë që gjente përpara". Kështu e nis tregimin Jani një shqiptar nga Mallakastër që ka mbi 20 vjet në rrethinat e Athinës, shumë pranë Atikës. Fatmirësisht familja e tij ka shpëtuar ndërsa emigrantit shqiptar ende nuhat kufoma të djegura. Qan vazhdimisht. Të gjithë dëshmitarët qajnë pasi ato momente tmerr që përjetuan nuk mund t'i harrojnë lehtë. Në një lidhje telefonike me NeWs24 & BalkanWeb, Bledi Stathi, banues në Rafina të Athinës tregoi se një pjesë e shtëpisë së tij ishte shkruar tërësisht. Ai madje tregoi edhe se si arriti të largohet në kohë nga vendi i ngjarjes së bashku me familjen e tij. "Gruaja më mori në telefon se unë isha në punë, dhe më tha që po digjej shtëpia përballë. Morëm djalin dhe ikëm, se nuk mundën të shpëtonin asgjë nga shtëpia. Shtëpia na u dogj, si u dogjën dhe shumë shtëpi të tjera, shqiptarësh e grekësh, por tani është stabilizuar gjendja," tha ai. Një tjetër dëshmitar shqiptarë që ishte rreth 100 metra larg vatrës së zjarrit ka treguar për momentet e vështira. "Nuk gjej dot fjalë të përshkruaj atë gjendje, ulërimat e njerëzve, flakët, makinat e shtëpitë e shkatërruara. Ne na largoi policia se zjarri po afrohej shumë në shtëpinë ku po punoja unë. Këtu janë djegur mbi 1000 shtëpi", thotë Albana Rrumbullaku. Nga të dhënat e para raportohet edhe për shqiptarë mes personave të vdekur edhe pse ende nuk ka njoftim zyrtar,



ndërsa disa prej tyre kanë përfunduar në spital nga asfiksia. Një çift shqiptarësh, të cilët shkuan për ndihmë mjekësore në spital, folën për "Top Channel": "Përfunduan në spital nga tymi i tepërt. Bashkëshortja nuk merrte dot frymë. Pësoi ankth. Nuk merrnim dot frymë". Përparim Vucaj një tjetër emigrant prej më shumë se 15 vitesh në Athinë, tregon se zjarri nisi papritur dhe u përhap shumë shpejt. "Mësuam në lajme që ka rënë zjarr disa kilometra larg, kur vetëm pas pak minutash, mori flakë edhe këtu pranë. Nxitum

menjëherë për t'u larguar", rrëfen Përparimi. Gjithsesi episodi më i tmerrshëm qëkur zjarret u përhapën me shpejtësi, është ai i regjistruar në Mati të Atikës, ku vullnetarët e Kryqit të Kuq gjetën 26 trupa njerëzish, shumë prej të cilëve nëna me fëmijë, të përgafuar me njëri-tjetrin. Jo të paktë janë edhe ata që janë mbytur, duke u hedhur në det për t'i shpëtuar flakëve, siç ndodhi në zonën e Artemidhës. Qindra vetë janë evakuuar me varka që janë helikopterë, ndërsa spitalet janë në gjendje emergjence.

## E marta e zezë, qindra viktima nëpër botë



E marta e 24 korrikut 2018, do të mbahet mend gjatë në Greqi, Japoni e Laos, pasi bilanci i viktimitave për shkaqe natyrore ka shkuar në disa qindra jetë të humbura. Të paktën 76 persona raportohet se kanë humbur jetën nga zjarri që ka përfshirë periferinë e Athinës, ndërkaq në Laos, për shkak të reshjeve të shumta dhe rrëshqitjeve të dherave me qindra persona raportohen të zhdukur, teksa 6600 persona kanë ngelur të pastrehë pasi shtëpitë e tyre janë mbuluar nga dherat. Ndërkohë që në Japoni raportohen se të paktën 65 persona kanë humbur jetën për shkak të temperaturave të larta në dy javët e fundit. Një zëdhënës i agjencisë paralajmëroi se nivelet të paprecedentë të të nxehtit, janë regjistruar në disa zona. Më shumë se 22 mijë persona në shtetin aziatik janë shtruar në spitalet si pasojë e atakëve kardiake, me rreth gjysmën e tyre të moshuar.

### SPITALET

Spitalet e Athinës janë vënë në gjendje emergjence, ndërkohë që ambulancat vazhdojnë të dërgojnë të plagosur dhe trupa të viktimitave. Zëdhënësi i qeverisë deklaroi se po bëhet e pa mundur për vënien e situatës nën kontroll dhe evidentimin sa më të saktë të numrit të viktimitave.

### DETI

Një pjesë e banorëve të rrezikuar nga zjarri janë hedhur në det e si pasojë, roja bregdetare njoftoi se ka shpëtuar më tepër se 700 persona nga plazhet e zonës së Rafinës. Gjatë orëve të natës në zonën Artemidhas u gjetën 4 persona të mbytur, ndërsa dëshmitarë okularë thanë se në ujë janë hedhur dhjetëra persona, fati i të cilëve është i pa ditur.

# REFORMA NË DREJTËSI REAGIMET

I ngarkuari me punë në ambasadën amerikane: Politikanët kanë frikë nga ligji

## Bllokimi i "Magjistraturës", SHBA: Është dështim i partive

"Vetingu po ecën shpejt, ka nevojë për gjyqtarë të rinj"

Në Shqipëri, i ngarkuari me punë në ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë David Muniz, e konsideron "një dështim i të gjitha partive në parlament", moskallimin dhe në seancën e fundit të parlamentit për këtë sesion, të ndryshimeve ligjore që do të sillnin zhbllokimin e regjistrimit të studentëve të rinj për këtë vit akademik në Shkollën e Magjistraturës dhe emërimin e të porsadiplomuave. Në përgjigje të interesimit të Zërit të Amerikës, zoti Muniz u shpreh se bëhej fjalë për "një amendim të thjeshtë të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të përmbyshur një kërkesë bazë të një sistemi drejtësie funksional, i cili lejon që studentët të rinj të hyjnë në Shkollën e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës përgatit brezin e ardhshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Shqipërisë - jashtë ndikimit politik - në mënyrë që shqiptarët më në fund të gjejnë drejtësi në gjykatat e tyre. Politikanët shqiptarë - vijoi më tej i ngarkuari me punë në ambasadën amerikane - kishin mundësinë ta ndërmerinin këtë hap të thjeshtë përpara dhe të hapnin dyert për një klasë të re studentësh, por nuk e bënë këtë". Sipas tij "vetingu po ecën më shpejt, dhe Shqipëria ka nevojë për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj që do të mbrojnë sundimin e ligjit. Me sa duket, politikanët kanë frikë nga sundimi i ligjit dhe prandaj nuk punuan së bashku për të mbështetur Shkollën e Magjistraturës dhe reformën në drejtësi", - u shpreh i ngarkuari me punë në ambasadën e SHBA.



David Muniz

### DEKLARATA

"Vetingu po ecën më shpejt, dhe Shqipëria ka nevojë për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj që do të mbrojnë sundimin e ligjit. Me sa duket, politikanët kanë frikë nga sundimi i ligjit dhe prandaj nuk punuan së bashku për të mbështetur Shkollën e Magjistraturës dhe reformën në drejtësi", - u shpreh i ngarkuari me punë në ambasadën e SHBA.



Gjatë seancës së fundit parlamentare

### Kreu i Grupit të LSI reagon pas deklaratës së të ngarkuarit të SHBA

## Vasili: Diplomatët harrojnë të flasin për Gjykatën Kushtetuese

Kreu i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili ka reaguar pas deklaratës së të ngarkuarit me punë në ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, David Muniz. Përmes një reagimi në rrjetin social "Facebook", Vasili shkruan se diplomatët e huaj "harrojnë" të flasin për Gjykatën Kushtetuese, e cila është e një rëndësie të madhe për funksionet që ka. Ndërkaq, deputeti Vasili ka bërë publike edhe rekomandimet që janë bërë nga konstitucionalistët në lidhje me Gjykatën Kushtetuese. "Diplomatët e huaj "harrojnë" të flasin për Gjykatën Kushtetuese, por ja ç'kanë thënë specialistët për të. Mungesa e



Gjykatës Kushtetuese është kritikë në Shqipëri për funksionet që ka dhe përcaktimet themelore kushtetuese, që lidhen me të. Këtë e kanë argumentuar shumë qartë specialistët më në zë të jurisprudencës shqiptare, që kanë kontribuar edhe për hartimin e reformës në

drejtësi", shkroi dje, Vasili. "Megjithatë mungesa e Gjykatës Kushtetuese është e një rëndësie kritike ka diplomatët të huaj që vuajnë nga një anezi (harresë) kritikë dhe vazhdojnë të flasin me një këmbëngulje artificiale, të pavend dhe të sforcuar për ligjin e magjistraturës, i cili s'ka aspak të bëjë me zgjidhjen e krerështjes së prerjes së kokës së sistemit të drejtësisë", -tha më tej, Vasili duke publikuar edhe materialin e duke iu sugjeruar ta lexojnë meqenëse "politika nuk jua mbush dot mendjen këtyre diplomatëve për rëndësinë e mungesës së Gjykatës Kushtetuese dhe urgjencën kombëtare që përbën zgjidhja e saj", -siç shprehet Vasili.

### Kreu i Komisionit të Ligjeve përsërit ftesën

## Ulsi Manja: Opozita ta votojë ligjin, po penalizohen studentët

Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja përsëriti ftesën ndaj opozitës për votimin e propozimeve për ndryshimin e ligjit të magjistratëve. Në të kundërt ata që do penalizohen janë studentët e rinj, theksoi Manja, duke mohuar çdo mundësi diskutimi për zgjidhjen me dakordësi të këtij problem të krijuar nga ngërçi ku është futur reforma në drejtësi. "Është një riskedullim afatesh të përcaktuara në ligj", -tha Manja për AbcNews. Kështu e theksoi kreu i Komisionit të Ligjeve Ulsi Manja shpërgjigjen e propozimit për ndryshimin e ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në nenet që prekin emërimet dhe caktimet e magjistratëve të sapa diplomuar. Bëhet fjalë për dispozitat kalimtare të ligjit, parashikimi i të cilave, në pritje të organeve të reja të drejtësisë, ka skaduar duke futur në lojë nënin që përcaktimin e kuotave të Shkollës së Magjistraturës ia ngarkon pikërisht Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe atij të Prokurorisë. "Ne nuk e kemi krijuar ende KLGJ dhe KLP që bën edhe emërimin dhe përcaktimin kuotat". Për opozitën, që refuzon votimin e propozimit socialist për zgjidhjen e situatës, përcaktimi me ligj i kuotave për magjistratë, si dhe rikthimi pa afat i tagrit emërues dhe caktues në duart e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, sot i përkohshëm, për ta është minimalisht kthim mbrrapa. Por, Manja thotë: "Edhe unë nuk jam shumë i lumtur t'i emëroj KLD ekzistuese apo Prokurori i Përgjithshëm, por ka ndryshuar mekanizmi i emërimit. Sot magjistratët në tri preferenca zgjedhin një dhe KLD është e detyruar t'i emërojë".



Një zgjidhje për këtë pakënaqësi, ia parashtrioi në komisionin e ligjeve përfaqësuesja e EURALIUS Agnes Bernhard kur propozoi ndarjen e nenit 160 në dy pjesë, në mënyrë që organet e vjetra të drejtësisë të mund vetëm të emërojnë dhe jo të caktojnë në pozicione magjistratë të rinj. Por propozimi i misionit EURALIUS mbeti vetëm në tavolinë dhe ligji kaloi në komision vetëm me votat e mazhorancës, të pamjaftueshme tashmë për ta miratuar në parlament. Për Ulsi Manjen ky është taksirati i magjistratëve të rinj.

opozitën. LSI- nga ana e saj tentoi që të vendoste një tryezë trepalëshe dialogu, por gjithçka dështoi. Kështu që ndryshimet që do të lejonin regjistrimin e studentëve të rinj në Shkollën e Magjistraturës dhe emërimin e atyre që janë diplomuar, mbetën pezull.

Kryetari demokrat Lulzim Basha, pas një mbledhjeje të grupit parlamentar propozoi një paketë me 7 pika për të zgjidhur ngërçin e krijuar. "Nëse ka një shans të fundit për të shpëtuar reformën në drejtësi, - deklaroi zoti Basha - ky është t'i rikthe-

hemi konsensusit të 22 korrikut dhe të marrim masa për t'i dhënë fund paligjshmërisë në organin e prokurorisë, për të patur një Gjykatë Kushtetuese funksionale, për t'i dhënë fund paligjshmërisë në përzgjedhjen e KLGJ-së dhe KLP-së".



Ngërçi në gjykata, kryeministri e kreu i PD-së replikojnë "online"

# Gjykata e Lartë, Rama: Më mirë djepi bosh se shejtani brenda

*Basha: Djepi bosh i Kushtetueses i duhet për të mbrojtur "Teatrin"*

Darina Tanushi

Mungesa e konsensusit për të kaluar projektligjin për Shkollën e Magjistraturës në Kuvend solli sërish dje, përplasje në distancë mes kryeministrit e kryetarit të Partisë Demokratike. Duke zgjeruar problemin si ngërç të sistemit të drejtësisë, palët duket se e kanë të vështirë të gjejnë gjuhën e përbashkët. Një ditë pas akuzave të opozitës, Kryeministri Edi Rama iu është përgjigjur PD-së dhe LSI-së. Në një reagim në rrjetet sociale, Rama tha se sistemi i drejtësisë po pasurohet dhe se është më mirë që ky sistem të zbrazet sesa të jetë i përbërë nga gjyqtarë e prokurorë të korruptuar. "Po mbetemi pa gjykata të sipërme? Jo! Po operojmë organizma të kancerizuar që e degraduan deri në kockë drejtësinë. Më mirë djepi bosh se shejtani brenda! Ky pastrim është shpëtim për dekada e breza që vijnë, rilindja e këtyre gjykatave është vetëm çështje e më pak se një viti", deklaroi dje, Rama.



Kryeministri Edi Rama

**EDI RAMA**  
"Po mbetemi pa gjykata të sipërme? Jo! Po operojmë organizma të kancerizuar që e degraduan deri në kockë drejtësinë. Më mirë djepi bosh se shejtani brenda! Ky pastrim është shpëtim për dekada e breza që vijnë, rilindja e këtyre gjykatave është vetëm çështje e më pak se një viti", deklaroi dje, Rama.

**LULZIM BASHA**

"Djepi bosh i Gjykatës Kushtetuese i duhet kryeshejtanit për të mbrojtur mega aferën 200 milionë euro me grabitjen e Teatrit Kombëtar. Ndërsa shejtanët në djepin e prokurorisë ju duhen për të mbrojtur lidhjet me krimin dhe aferat korruptive", u shpreh dje, kryetari i PD-së, Lulzim Basha.



Deputeti i LSI-së: Klasa politike i ka mundësitë të negociojë

## Nasip Naço: 7 propozimet janë të PD-së, por disa mund të negociohen

Lëvizja Socialiste për integrim vijon me qëndrimin e saj se dialogu politik është drita jeshile për p/ligjin për magistratët, por sipas saj mazhoranca nuk është e interesuar për t'i dhënë zgjidhje ngërçit sistemit të drejtësisë. "Klasa politike i ka të gjitha mundësitë që të ulët të negociojë dhe të japë një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore. Jo për të bërë pazare, por për të gjetur një zgjidhje kushtetuese dhe ligjore", tha dje, ish-ministri, Nasip Naço, për Ora News. Por deputeti i LSI-së Nasip Naço tregon që nëse Presidenti i Republikës dekreton ligjin për Teatrin, Gramoz Ruçi do të mbledhë parlamentin në seancë të jashtëzakonshme. "Gojë e liga thonë se do të kthehen nga pushimet nëse Presidenti do kthejë ligjin për teatrin. Ata janë të interesuar dhe të jeni të bindur që do vijnë, dhe për reformën në drejtësi nuk janë të interesuar, sepse ata kanë mesinë mbi tokë, Edi Ramën", u shpreh Naço. Naço shprehet se 7 kushtet e Bashës për marrëveshje janë vetëm të Partisë Demokratike dhe disa prej tyre mund të jenë edhe të negociueshme. "Besoj që ato janë kushte të PD. Ka disa pika që mund dhe duhet të negociohen", tha ai. Ndërsa në lidhje me bashkëpunimin e LSI për zgjedhjet lokale, Naço ka edhe një propozim për partinë e vet për qarkun e Beratit ku ai është deputet. "Në qarkun e Beratit do të doja të dilja vetëm me të gjithë kandidatët që mund të jenë në 5 bashkitë e Beratit", theksoi Naço.

## Kreu i PD pret ministrin gjerman, i paraqet 7 propozimet

### Basha me Roth: Kjo qeveri e lidhur me krimin, Shqipëria e ka të vështirë "BE"-në

Përbushja e kushteve të vendosura Shqipërisë për hapjen e negociatave, që nga shteti ligjor, lufta kundër krimit e korrupsionit e deri tek drejtësia e pakapuri politikisht ishin në qendër të takimit të kryetarit të PD, Lulzim Basha me ministrin gjerman të Shtetit ne Ministrinë e Jashtme Gjermane, Michael Roth. Duke e falënderuar ministrin Roth për angazhimin e tij personal që çështja e Shqipërisë të mos hiqej nga axhenda e vendeve anëtare gjatë Samitit të Luksemburgut, në fund të qershorit, zoti Basha tha se me refuzimin që qeveria po i bën marrjes në konsideratë të kushteve të vendosura për Shqipërinë, rrezikohet që edhe vitin tjetër vendit të mos i hapen negociatat. Me një qeveri të



lidhur me krimin, Shqipëria e ka të pamundur të bëjë progres në rrugën drejt BE. Për këtë lideri i opozitës solli si shembull rastin e dy ministrave të brendshëm Tahiri e Xhafaj dhe përdorimin e vetingut si mjet presioni ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'u garantuar paprekshmërinë qeveritarëve të lidhur me krimin e të përfshirë në afëra të mëdha kor-

ruptive, siç është edhe rasti i fundit me ligjin special për shembjen e Teatrit Kombëtar. Zoti Basha u ndal në mënyrë të detajuar tek reforma në drejtësi, e cila me ndryshimet dhe amendamentet e bëra nga qeveria është kthyer në padrejtësi, në pushtet ndëshkues në duart e qeverisë. Basha e njohu ministrin gjerman me 7 propozimet e opozitës për zgjidhjen e kolapsit të krijuar nga ndërhyrjet politike për kapjen e drejtësisë. Lideri i opozitës shprehu bindjen se këto probleme madhore nuk zgjidhen me korrigjime sipërfaqësore, por me një qasje tërësore e të mirëmenduar. Për këtë zgjidhje, Lulzim Basha siguroi ministrin gjerman të Shtetit, përgjegjës për Europën, se opozita është e gatshme të kontribuojë në mënyrë konstruktive.

son se "në Shqipëri nuk është problemi tek kapja e kriminelëve po tek lirimi i tyre nga gjykatat". Ndërsa nga ana e tij, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, në një konferencë për shtyp, ditën e hënë renditi 7 propozime drejtuar mazhorancës për të gjetur zgjidhjen e ngërçit në sistemin e drejtësisë. "Respektimi i kushtetutës së miratuar me konsensus në korrikun 2016, që do të thotë zbrërje e ligjeve në kundërshtim me Kushtetutën. Zgjidhja e situatës së

paligjshmërisë në organin e prokurorisë, duke i dhënë fund kapjes politike të Prokurorit të Përgjithshëm; zgjidhja e situatës së paligjshmërisë në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të jashtëm të KLGJ-së e KLP-së; zgjidhja urgjente e ngërçit të krijuar në Gjykatën Kushtetuese; zgjidhja urgjente e ngërçit për ngritjen sa më shpejt të KLGJ dhe KLP sipas Kushtetutës, që të zhblokohet edhe krijimi i SPAK dhe


BKH", këto janë disa nga propozimet e Bashës. Po ashtu ai propozoi ecuri kushtetuese dhe ligjore të procesit të vetingut; ndërprerje të menjëhershme të ndërhyrjes politike me proces nga ana e mazhorancës, që ka sjellë deri tani një proces të deformuar. E në fund ai kërkoi edhe ngritjen e një komisioni koordinimi i balancuar dhe i paanshëm për të mbikëqyrtur konstitucionin e organeve të reja të drejtësisë.

Kreu i qeverisë mbledhi në Pallatin e Brigadave anëtarët e kabinetit për analizën e 10 mujorit

# Ndryshimet në shtator, Rama merr në "testim" ministrat

Dy ditët e analizës, ministrat paraqesin planet për muajt në vijim

I gjithë kabineti qeveritar do të kalojë për dy ditë me radhë në analizë. Kryeministri Edi Rama nisi dje, një analizë pune me të gjithë ministrat e kabinetit që drejton, analizë kjo që do të vijojë edhe sot, në mjediset e Pallatit të Brigadave. Burimet bënë me dije se secili ministër do të paraqesë të detajuar punën e bërë në këta 10 muaj të mandatit të dytë qeverisës. Prezantimet do të kenë edhe bazën krahasuese me objektivat që secili ka patur në shtator të 2017, atëherë kur nisi edhe rrugëtimi i dytë i qeverisë "Rama". Veç kësaj çdo ministër duhet të detajojë edhe planin e punës dhe projektet që ka në muajt në vijim. Më pas do të jetë kryeministri Edi Rama që do të bëjë vlerësimet e tij, gjatë muajit gusht për t'i bërë ato publike ndoshta në një mbledhje të Asamblesë Kombëtare që mund të mbahet në muajin shtator. Gjatë mbledhjes së Asamblesë Kombëtare të PS, pak muaj më parë, kryeministri Rama paralajmëroi ndryshime në qeveri, në muajin shtator. Ndaj edhe secili ministër tashmë është në testim për atë që ka bërë në këta muaj. Gjatë fjalës së tij në Asambelën e PS, mbajtur në fund të prillit, Rama paralajmëroi ndryshime në kabinetin qeveritar në shtator, teksa tha se do shihet se cilët ministra apo ministrë nuk janë në lartësinë e duhur dhe nuk kanë bërë punën si duhet. Ai tha, gjithashtu, se do shihet se cilët anëtarë të partisë do të largohen nga kryesia dhe cilët janë të rinjtë që duhet të vijnë. "Pse thonë njerëzit që ne qeverisim me arrogancë? Cila pjesë e qeverisjes sonë konsiderohet arrogante, sepse është e drejtë, sepse ne bëjmë reforma të dhimbshëm dhe cila pjesë e qeverisë është arrogante me njerëzit. Këtë ne duam ta ndajmë", u shpreh Rama në këtë mbledhje asambleje. "Ndryshime në qeveri në shtator nëse duhet të bëjë, do të shohim cilët ministra, ministër, cilët nuk janë në lartësinë e kësaj nevojë, jo thjeshtë të tregojnë shifra e statistika, por të kenë vendin e tyre në mendjen dhe zemrat e atyre që na kanë dhënë besim. Do shohim cilët anëtarë të partisë do të largohen nga kryesia dhe cilët janë të rinjtë që duhet të vijnë, si ka punuar sekretariati dhe cilët do vijnë, cilët janë kryetarët e PS që do të ikën, detyra kryesore është bashkëqeverisja", tha Rama. Gjithsesi për këtë mbetet edhe pak kohë derisa të bëhet publike. Nga ana tjetër, kryeministri mundet të japë "OK"-in e tij për të gjithë ministrat, duke vlerësuar punën e tyre. Deri më tani ai nuk është shprehur publikisht për asnjë prej tyre.



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

Zv. kryeministria Mesi: Menaxhimi i mirë i kufijve, garanci për shtetet tona

## Pika e kalimit në Morinë, Vlahutin: Kosovë-Shqipëri, në BE me standarde

Hapet pika e kalimit kufitar, e revitalizuar, ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, në Morinë. Revitalizimi i pikës së kalimit përfshin kabina të reja kontrolluese, sistem elektronik dhe ndërtesën administrative, të cilat do të mundësojnë zbatimin e menaxhimit të integruar të kufirit. Pikë-kalimi kufitar në Morinë e mbulon pjesën më të madhe të qarkullimit të mallrave përmes Kosovës, si dhe pothuajse të gjithë trafikun turistik që hyn në Shqipëri nga Kosova. Projekti prej një milion euro, i financuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, ofron infrastrukturë për kontrollë efikase të kufirit, në përputhje me kërkesat e BE-së duke pasur parasysh standardet e Schengenit. Pikë kalimi i rindërtuar kufitar mbështet punën e policisë kufitare dhe të migracionit, duke kontribuar në arrijtjen e efikasitetit më të lartë dhe performancën më të mirë. Në ceremoni morën pjesë shefat e BE-së në Kosovë dhe Shqipëri, Nataliya Apostolova, dhe Romana Vlahutin, zëvendëskryeministri i Kosovës Enver



Hoxhaj, dhe zëvendëskryeministria e Shqipërisë, Senida Mesi. Ambasadorja Vlahutin, tha se "kjo pikë mundëson bashkëpunim më të mirë dhe efikas. Sot nuk po hapim një ambient të ri me 12 korsi, por po i lidhim dy vendet për t'i dërguar në BE me standarde. Nga ky projekt do të përfitojnë jo vetëm qytetarët, por edhe bizneset. Integrimi i suksesshëm ekonomik kërkon bashkëpunim në mes dy institucioneve". Zëvendëskryeministria e Shqipërisë, Senida Mesi theksoi se ky inaugurim vjen në një kohë kur Kosova dhe Shqipëria kanë marrë dy lajme të mira, liberalizimi i vizave

për Kosovën dhe data për hapjen e negociatave për Shqipërinë. Znj. Mesi ndër të tjera u shpreh: "Rekomandimi që mori Kosova për liberalizimin e vizave dhe rrugëtimi evropian i Shqipërisë, shtojnë angazhimet e qeverisë për sigurimin, kontrollin e integruar dhe menaxhimin cilësor të kufijve, është jo vetëm garanci për shtetet tona, rajonin e BE-në, por, gjithashtu, ka rëndësi të veçantë dhe është një bonus në përpjekjet e vendeve tona për të hyrë nesër në familjen e madhe evropiane".



Kjo është lista e katërt që propozohet nga qeveria shqiptare

## Qeveria propozon 3 emra të tjerë për gjyqtar të Shqipërisë në Strasburg

Qeveria ka propozuar një treshe të re emrash për gjyqtar të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Shqipëria zhvilloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve që rekomandohen për pozicionin e gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Numri i aplikantëve që përmbushin kriteret e shpallura në njoftimin për aplikim ishte 16, ndërkohë që komisioni ad-hoc, në përfundim të procesit përzgjedhës, pas vlerësimit të aplikantëve, rekomandoi listën me 3 kandidatë për pozicionin e gjyqtarit të Shqipërisë në GJEDNJ (sipas rendit alfabetik), si më poshtë: Darian Pavli; Marjana Semini dhe Sokol Berberi. Darian Pavli është jurist me 15 vjet përvojë në disajnimin, koordinimin dhe zbatimin e aktivitetëve që promovojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Nju-Jork, Tiranë, përfshirë rajonin e Këshillit të Evropës, ekspert ligjor pranë EURALIUS V, këshilltar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar i Reformës në Drejtësi. Marjana Semini - juriste me përvojë të spikatur në fushën e së drejtës; mbajtëse e titullit "Profesor i asociuar", profesore e brendshme në Shkollën e Magistraturës për 20 vjet dhe drejtore e saj (2009-2013), eksperte e lartë e Komisionit të Reformës Ligjore, si dhe e organizatave të huaja (USAID, BB, UNESCO, BERZH etj.), specializime për të drejtat e njeriut, autore dhe bashkautor e disa botimeve. Ndërsa Sokol Berberi është jurist me përvojë të spikatur në fushën e së drejtës, anëtar i Gjykatës Kushtetuese (prill 2007 - shtator 2016), mbajtës i titullit "Doktor", profesor në disa disiplina të së drejtës, kontribuues në përfundimin e legjislacionit shqiptar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut etj..

### Propozimet

Shqipëria zhvilloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve që rekomandohen për pozicionin e gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Numri i aplikantëve që përmbushin kriteret e shpallura në njoftimin për aplikim ishte 16, ndërkohë që komisioni ad-hoc, në përfundim të procesit përzgjedhës, pas vlerësimit të aplikantëve, rekomandoi listën me 3 kandidatë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 31.07.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharrem Hysen Greca: Binarësi dykrahshme me sipërfaqe totale 333.16m2, e ndodhur në zonën kadastrale 6190, Velibërdanuar pranë Drejtorisë së ALIUZINI Tiranë Jug me nr. 425 datë 28.08.2006, adresa: Rruga "3 Vellëzërit Konda", Tiranë.  
Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 4 311 075 (katër milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 01.08.2018, Ora 16:30  
Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "ALSION" sh.p.k: "Njësi" me sipërfaqe 300m2, nr i pasurisë 15/392-N1, zona kadastrale 8523, vol. 38, faqe 4, adresa: Lagja "Sytja Dytëjore", Elbasan.  
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 25 200 000 (njëzet e pesë milionë e dyqind mijë) lekë.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 01.08.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "VIGAND Konstruktion" sh.p.k: "Njësi" me sipërfaqe 265.22 m2, nr i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresa: Rruga "Petra Nini Luasari", Tiranë.  
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 237 637 (dyqind e tridhjetë e shtatëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) EUR.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

**Ndryshon trendi i mesatares për universitetet**

**Pranimet, kushtet për Ekonomikun dhe Gjuhët e Huaja**

**KRITERET**  
fitues shpallen ata që plotësojnë këto kushte: "Në 100% të pikëve, 50% e ka nota mesatare e shkollës së mesme dhe 50% mesatarja e notave të 4 lëndëve, matematika, ekonomia, fizika gjuha e huaj", u shpreh Dhori Kule. Për t'u pranuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja duket se është më e thjeshtë, por ka ndryshuar trendi i mesatares. Atë nuk e ndjekin më të dobëtit.



dekanit Sula, tregu ka gjithmonë e më shumë nevojë për përkthyes. Ndërsa prioriteti që merr një gjuhë e huaj apo një tjetër lidhet ngushtësisht me mundësitë që ofron tregu për punë. "Kapitalet dhe investimet e huaja do të kërkojnë gjithmonë njerëz që dinë gjuhë të huaja, do kërkojnë guida turistike, përkthyes. Për shembull në 'call center' e para është gjuha italiane, apo edhe gjermanishtja, pasi ofron kontrata pune", tha Sula.

Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës mbetet gjithashtu në krye të listës sa u takon kërkesave. Por, fitues shpallen ata që plotësojnë këto kushte: "Në 100% të pikëve, 50% e ka nota mesatare e shkollës së mesme dhe 50% mesatarja e notave të 4 lëndëve, matematika, ekonomia, fizika gjuha e huaj", u shpreh Dhori Kule. Për t'u pranuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja duket se është më e thjeshtë, por ka ndryshuar trendi i mesatares. Atë nuk e ndjekin më të dobëtit. "Mesatarja e thjeshtë e viteve të shkollës së mesme dhe notave të provimeve të Maturës Shtetërore. Vjet patëm një ng-

ritje të kufirit të mesatares. Nuk jemi të 6, por jemi diku të 7.8", shprehet Artur Sula. Për dekanin e Ekonomikut, ka një arsye thelbësore pse maturantët duhet të zgjedhin këtë fakultet: "Duhet të aplikojnë sepse shkolla bëhet për të gjetur punë. Kush merr diplomën e ekonomikut, e ka punën e sigurt", tha Dhori Kule. Sipas

Janë në total rreth 60 mijë banesa në të gjithë vendin që do të pajisen me tapi

Ornela Manjani

**Ndërtimet para vitit 1991, zbardhet formulari për legalizim**  
*Certifikatat e pronësisë, afatet dhe dokumentet*

Personat që kanë ndërtuar para vitit 1991 dhe që nuk kanë dokument pronësie si për ndërtesën, ashtu edhe për truallin do të pajisen me tapi. Janë në total 60 mijë ndërtime në të gjithë vendin që do legalizohen. Pronarët e këtyre ndërtimeve duhet të paraqiten pranë ALUIZNI-t dhe të plotësojnë formularin-tip, i cili publikohet sot në "Gazetën Shqiptare". Këshilli i Ministrave miratoi pak ditë më parë vendimin që i hap rrugë nisjes së procedurave, të cilat do të ndiqen nga ALUIZNI për pajisjen me dokument pronësie të këtyre pronave. Sipas vendimit, mësohet se ndërtimet e ngritura deri më 10.8.1991 dhe tregjet funksionale të tyre, për të cilat nuk ka akte të fitimit të pronësisë do të pajisen me tapi. Vetëm nëse për truallin ka dokumentacion pronësie, procedurat e kalimit të pronësisë kryhen vetëm për ndërtesën. Vendimi përcakton se do të konsiderohen objekt i trajtimit të këtij vendimi ato ndërtime: a) të cilave u mungon akti i fitimit të pronësisë; b) të cilat, nga pikëpamja ndërtimore janë të përfunduara, me mure dhe me mbulesë; c) të cilat nuk janë ndërtime pa leje, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të nenit 3, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Ndërsa truall funksional konsiderohet sipërfaqja e tokës nën ndërtesë, së bashku me oborrin përreth saj, që posedohet efektisht nga subjekti kërkuar. Sipas këtij vendimi, ALUIZNI është institucioni i autorizuar për kryerjen e procedurave administrative. Kalimi i pronësisë së ndërtimit dhe truallit funksional për sipërfaqet deri në 300 metra katrorë kryhet pa pagesë, nëpërmjet dokumentit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi. Procedurat e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendi-

mi fillojnë: a) me kërkesë të subjektit/subjekteve, sipas modelit të kërkesës së miratuar me këtë vendim, pavarësisht nëse zona kadastrale i është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistem-

truesi, njoftohet ALUIZNI për verifikimin e kushteve dhe vendimmarrjen, sipas këtij vendimi; c) me kërkesë të institucionit shtetëror, në rastet e shpronësimit për shkak të zbatimit të projekteve publike, pavarësisht nëse zona kadastrale i është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistematik. Në vendim përcaktohet se ALUIZNI evidenton në terren ndërtimin dhe truallin funksional, duke verifikuar paraprakisht bazën e të dhënave të ndërtimeve pa leje, nëse për të është paraqitur aplikim për legalizim. Gjatë evidentimit në terren verifikohet edhe posedimi efektiv i ndërtimit nga subjekti përfutës. Ndërkohë të dhënat e kërkesës dhe të evidentimit në terren bëhen publike për 30 ditë, në ambientet e njësive administrative ku gjendet pasuria, në ambientet e ALUIZNI-t, ZVRPP-së si dhe në faqet përkatëse ueb. Si rregull, nëse për ndërtimin është aplikuar për legalizim si ndërtim pa leje, ai përjashtohet nga fusha e zbatimit të këtij vendimi dhe trajtohet sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Përjashtim bën rasti kur nga korrespondenca e ALUIZNI-t me organet kompetente (të vetëqeverisjes vendore dhe Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit-AQTN) apo nga dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi arrihet të provohet se ndërtesa është ndërtuar përpara datën 10.8.1991.

**PËRCAKTIMI I SIPËRFAQES**

Në përcaktimin e sipërfaqes, ALUIZNI bazohet në kufijtë faktikë të sipërfaqes së poseduar, pa tejkaluar masën prej 300 metrash katrorë.  
1. Për procedurën e ndjekur, subjekti përfutës paguan për llogari të ALUIZNI-t tarifën e shërbimit në vlerën 8 000 (tetë mijë) lekë për çdo kat ndërtimi, e cila përdoret për të përballuar shpenzimet e evidentimit në terren dhe shpenzimet e tjera të procedurës administrative. Kjo tarifë i njoftohet përfutës menjëherë pas përfundimit të periudhës së afishimit, nëse përmbushen kushtet për të përfutur kalimin e pronësisë, sipas këtij vendimi.  
2. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet në favor të subjektit kërkuar dhe bashkëshortit/ës së tij, duke respektuar dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore martesore. Në rast se subjekti nuk paraqesin dokument që provon regjim pasuror martesor të veçantë apo marrëveshje të posaçme noteriale për të drejtat mbi ndërtesën, vendimi miratohet në favor të dy bashkëshortëve, duke prezumuar regjimin e bashkësisë ligjore. Për zbatimin e kësaj pike, ALUIZNI administron certifikatën familjare të kërkuarit, sipas mënyrës së përcaktuar në vendimin nr.332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet brenda 20 ditëve nga administrimi i vërtetimit për pagesën e tarifës së shërbimit, por në çdo rast jo më herët se data e përfundimit të afatit të njoftimit publik.  
3. ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin, së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.

Llogariten sipërfaqet takuese për pronarët, poseduesit marrin tapinë

Ornela Manjani

Këshilli i Ministrave ka miratuar të drejtën për kalimin e pronësisë të parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale. Bëhet fjalë për 600 parcela ndërtimore në të gjithë vendin, kur personat që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapinë mbi truallin. Sipas listës së miratuar nga qeveria dhe të botuar në Fletoren Zyrtare mësohet se është përllogaritur sipërfaqja takuese, ku në pjesën më të madhe të raste ka ndryshime në m<sup>2</sup> që përfitojnë pronarët. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe pronarët e truallit do të marrin certifikatën e

# Qeveria miraton të drejtën mbi pronën për 600 ndërtime

## Lista me përfituesit në të gjithë vendin

pronësisë mbi tokën ku kanë ndërtuar.

### TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUZIONI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e

Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohe që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për

ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m<sup>2</sup>. Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të

ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më

### LISTA ME PËRFITUESIT

ISHTE - BËHET	NR. I TRASHËGIMIT ARËV E NË VKM-në E	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI
<b>LIDHJA A</b>				
<b>VKM NR. 616, DATË 11.6.2009</b>				
ISHT	17	ASLLAN		CEKREZI
BËH	1	ASLLAN		CEKREZI
ISHT	15	MIDE		CEKREZI
BËH ET	2	NEVILA		AVXHI
	3	MIDE		AVXHI
<b>LIDHJA B</b>				
<b>VKM NR. 1039, DATË 14.10.2009</b>				
ISHTE	110	ZEQINE	SHABAN	KOKONOZI
	111	AGIM	SELIM	KOKONOZI
	112	SAMI	SELIM	KOKONOZI
	113	MAHMUT	SELIM	KOKONOZI
	114	BARDHYL	SELIM	KOKONOZI
	115	BAHRI	SELIM	KOKONOZI
	116	HYSEN	SELIM	KOKONOZI
	117	PRANVERA	SELIM	KOKONOZI
	118	NAIME		KOKONOZI
	119	FIQIRETE		KOKONOZI
	120	HANKE		KOKONOZI
	121	ADRIAN		NAXHAKU
	122	ANOLA		NAXHAKU
	123	ARTAN		DERVISHI
	124	ARTAN		DERVISHI
	125	ANILA		MANÇJA
	126	GENC		MANÇJA
	127	EDUART		HOTI
	128	FATMIR		KOKONOZI
129	HALLIL		KOKONOZI	
ISHT	4	ZEQINE	SHABAN	KOKONOZI
	5	AGIM	SELIM	KOKONOZI
	6	SAMI	SELIM	KOKONOZI
	7	MAHMUT	SELIM	KOKONOZI

BËHET	8	BARDHYL	SELIM	KOKONOZI
	9	BAHRI	SELIM	KOKONOZI
	10	HYSEN	SELIM	KOKONOZI
	11	PRANVERA	SELIM	KOKONOZI
	12	NAIME		KOKONOZI
	13	FIQIRETE		KOKONOZI
	14	HANKE		KOKONOZI
	15	ADRIAN		NAXHAKU
	16	ANOLA		NAXHAKU
	17	ARTAN		DERVISHI
	18	ARTAN		DERVISHI
	19	ANILA		MANÇJA
	20	GENC		MANÇJA
	21	EDUART		HOTI
ISHT	22	FATMIR		KOKONOZI
	23	HALLIL		KOKONOZI
BËHET	24	BESNIK		KAZIU
	25	DIANA		KUÇI
	26	ENGJELLUSHE		ZHURI
	27	MUSTAFA		KAZIU
	28	RUKIE		MERLIKA
	29	BUJAR	RIFAT	HOXHA
	30	HAJREDIN	RIFAT	HOXHA
ISHT	31	SKENDER	RIFAT	HOXHA
	32	FATIME		KULLA
BËHET	33	MAJLINDA		HOXHA
	34	ALBANA		HOXHA
	35	FLORINDA		HOXHA
	36	GEZIME		HOXHA
	37	MAJLINDA		HOXHA
	38	ALBANA		HOXHA
	39	FLORINDA		HOXHA
ISHT	40	Mahmut		Shengjergji
	41	Leme		Shengjergji
Trashëgim tarët-30				

BËHET	37	MILJ	MAHMU	SHINGJERGJI	
	38	MEREME	IBRAHIM	SHINGJERGJI	
	39	BARDHYL	ALI	SHINGJERGJI	
	40	ALEM SHAH	ALI	SHINGJERGJI	
	41	MAHMUT	ALI	SHINGJERGJI	
	42	LIRI	ALI	SHINGJERGJI	
	43	EDUART	ALI	SHINGJERGJI	
	44	DASHURI	ALI	SHINGJERGJI	
	45	HILMI	HAMIT	SHINGJERGJI	
	46	SHEMSI		MAVJANI	
	47	TEUTA	SHEMSI	MAVJANI	
	48	SOKOL	SHEMSI	MAVJANI	
	49	LIRI		SHINGJERGJI	
	50	NEVJANA		SHINGJERGJI	
	51	ABDULLAH		BALLHYSA	
	52	VJOLLÇA		BALLHYSA	
	53	RUZHDIJE		SHINGJERGJI	
	54	HASAN		MATRAXHIU	
	55	HEDIJE		MATRAXHIU	
	56	AIDA		MATRAXHIU	
	57	SAIMIR		MATRAXHIU	
	58	VANTHI		SHINGJERGJI	
	59	ARMAND		SHINGJERGJI	
	60	LINDITA		SHINGJERGJI	
	61	MANJOLA		SHINGJERGJI	
	62	LORETA		SHINGJERGJI	
	63	KRISTO		SHINGJERGJI	
	64	ALBERT		SHINGJERGJI	
	65	MENCURI		SHINGJERGJI	
	66	FLUTURAKE		SHINGJERGJI	
	ISHT	403	MAHMUT		SHENGJERGJ
		404	LEME		SHENGJERGJ
		Trashëgim tarët-30			
		67	SHYQYRI	IBRAHI	KOBURJA
		68	ZENEPE	IBRAHI	KOBURJA
	69	HASAN	IBRAHI	KOBURJA	
70	XHEVAT	IBRAHI	KOBURJA		
71	MYRTEZA	IBRAHI	KOBURJA		

(vijn)



**TIRANË** - Kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori ka kaluar me sukses procesin e vetingut, duke u rikonfirmuar në detyrë. Katër ditë pas seancës dëgjimore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që drejtohej nga Olsi Komici dhe me anëtarë Roland Ilija dhe Pamela Qirko kreu një hetim të thelluar administrativ dhe vendosi konfirmimin në detyrë të Zaganjorit. Ai është gjykatësi i dytë i Gjykatës së Lartë që konfirmohet në detyrë. Fillimisht, KPK



Kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori

## Vetingu, KPK konfirmon në detyrë kreun e Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori

vlërësoi se kreu i Gjykatës së Lartë pati bërë deklarime të pasakta të pasurisë dhe kontrata fiktive. Konkretisht, në gjetjet e komisionit thuhej se gjyqtari kishte bërë kontrata fiktive në hipotekë për një apartament, dyqan, bodrum dhe një zyrë duke deklaruar se vlera e tyre ishte 500 mijë lekë. Këtë veprim, Zaganjori e argumentoi me pretendi-

min se në truallin e familjarëve të gruas së tij është ndërtuar një pallat 5-katësh. Ndërkaq, ai u mbrojt duke thënë se kontratat ishin formale për pronën dhe brenda ligjit. Kryetari i Gjykatës së Lartë zotëron një pasuri familjare me vlerë rreth 58.7 milionë lekë, ndërkohe që të ardhurat ndër vite llogariten në 99.7 milionë lekë.

Vendimi për të pritet me interes të lartë, pasi nëse do të shkarkohej, edhe gjykata do futej në kolaps. Vendimi i arsytuar pritet që të publikohet në faqen zyrtare të KPK pas 15 ditëve. Aktualisht Gjykata e Lartë është me vetëm 6 anëtarë, ndërsa në ditët në vijim pritet që të kalojnë në filtrer edhe anëtarët e tjerë.

Ngjarja në Vlorë/ Zambak Hoxhallari: Bëra 3 vite burg kot, kërkoj pafajësi

# "Nusja u bëri petulla me ilaç gjumi, pastaj bashkë me të dashurin i vranë dhe i dogjën"

## Familjarët e viktimave Salkie e Olsi Hoxhallari në "News 24": Kunata donte të merrte shtëpinë e pasurinë

TIRANË

Ngjarja tragjike e 22 janarit të këtij viti në lagjen "1 Maji" të Vlorës, ku nënë e bir u vranë dhe më pas u dogjën në banesën e tyre nga nusja e shtëpisë është bërë dje pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" në "News 24". Viktimat ishin Salkie Hoxhallari, 73 vjeçe dhe i biri, Olsi 43 vjeç, ndërsa ekspertiza tregoi se djali ishte goditur me sëpatë në kokë, ndërsa e moshuara ishte mbytur me tel në gjumë. Për ngjarjen në fjalë u arrestua nusja, Hysnie Hoxhallari dhe Kasem Pirjasi, me të cilin ajo kishte një lidhje jashtëmartesore. Fillimisht, nusja mohoi ngjarjen, madje deklaroi se kishte qenë në gjumë kur kishte ndodhur krimi, por pas hetimeve të policisë, rezultoi se ajo ishte bashkëpunëtore në krim. Të afërmit e viktimave, vajzat dhe djali i familjes Hoxhallari hedhin dritë mbi të tjera detaje nga historia makabre, që i ngjan një skenari të filmave të Hollivudit. Teksa kërkojnë drejtësi dhe dënimin e autorëve të vrasjes së nënës dhe vëllait të tyre, ata flasin për konfliktin e ri që ka nisur për banesën ku kanë të drejtën e pronësisë. Vajzat e shtëpisë, Lindita dhe Miranda, të cilat janë të martuara tregojnë se Hysnija u kishte bërë petulla me ilaç gjumi në darkë vëllait të tyre dhe nënës dhe më pas i ka vrrarë në bashkëpunim me Kasemin për të marrë pasurinë.

### DËSHMIA E FAMILJARËVE

"Ne na njoftuan se është djegur mamaja me vëllain me bombol. U nisëm për në Vlorë dhe atje mësuam se ata i kishin vrrarë. Në orën 5 të mëngjesit vjen Hysnija dhe i bie të fikët. I thotë teza si ndodhi ngjarja. Ajo thotë se kishte rënë zjarr tek kuzhina. Hysnija mendonte për pasurinë e shtëpisë që në tri ditët e para të ngjarjes. Hysnija u ka bërë petullat dhe atje ka hedhur ilaçin e gjumit. Më pas, në atë moment ka hyrë Kasemi dhe kanë vrrarë nënën dhe vëllain dhe i kanë vënë flakën shtëpisë. Na ka thënë vetë Hysnija që u kishte bërë petulla atë natë. Madje, ajo ishte djegur edhe vetë pak dhe ishte lyer me kolinoz. Nëna dhe vëllai kishin ngrënë pet-



Vajzat e familjes Hoxhallari në "News 24"



Viktimat, Salkie dhe Olsi Hoxhallari

ulla, ndërsa djali dhe Hysnija nuk kishin ngrënë. Hysnija donte të merrte pasurinë e vëllait. Pronat, shtëpinë që ka ndërtuar babai dhe vëllai. Shtëpia është e mbyllur që pas ngjarjes. Ndër të tjera, ato rrëfyan se në llogarinë bankare ishin 48 mijë euro në emër të nënës së tyre dhe të vëllait, të cilat i ka marrë nusja e shtëpisë, e

cila akuzohet për vrasjen. "Hysnija kishte bërë përpara vrasjes dokumentet për trashëgiminë e shtëpisë. Nga 48 mijë euro, ajo ka tërhequr gjysmën, ndërsa pjesa tjetër e parave ka mbetur e ngrirë. Ne i kemi thënë prokurorit për të kërkuar celësin për të hapur derën, por ai na ka thënë që duhet ta zgjidhni vetë këtë çështje. Nuk dyshonim që Hysnija kishte lidhje jashtëmartesore", u shprehën të afërmit e viktimave. Ndërkohë djali i famil-

### ZAMBAK HOXHALLARI

Zambak Hoxhallari, i cili ka dalë nga burgju para 3 javësh, pasi ishte dënuar me 3 vite për grabitjen e disa dokumenteve dhe 1 mijë eurove, pohoi se grabitjen e lekëve e ka bërë nusja e shtëpisë, Hysnija dhe ai është i pafajshëm. Ai deklaroi se ngjarja do të ishte parandaluar nëse policia do kishte arrestuar kunatën e tij për grabitjen e lekëve në shtëpi.

jes, Zambak Hoxhallari, i cili ka dalë nga burgju para 3 javësh, pasi ishte dënuar me 3 vite për grabitjen e disa dokumenteve dhe 1 mijë eurove pohoi se grabitjen e lekëve e ka bërë nusja e shtëpisë, Hysnija dhe ai është i pafajshëm. Ai deklaroi se ngjarja do të ishte parandaluar nëse policia do kishte arrestuar kunatën e tij për grabitjen e lekëve në shtëpi. "Unë jam akuzuar për vjedhjen e disa dokumenteve. Lekët ishin tërhequr nga ato dokumente. I kishte tërhequr babai. Ne nuk denoncuan grabitjen e 1 mijë eurove. Familja nuk bëri asgjë për të dalë nga burgju. Tek dokumentet ishin libreta e shtëpisë dhe dokumente të tjera. Në këtë histori, pleqtë dyshonin për ish-gruan time dhe Hysnijën.


Kur vdiq babai, unë takova nënën dhe motrat. Në burg ka ardhur edhe Hysnija, e cila kërkonte të humbiste gjurmët. Vëllai më tha se i kishte vjedhur gruaja e tij kur më takoi në burg. Olsi ishte pak i frikësuar. Unë i thashë që të ruhej, sepse ishte i frikësuar. Nuk e di, ndoshta i kanë bërë preion. Nuk e besojta dot kur mora vesh vdekjen e nënës dhe të vëllait. Në fillim mora vesh se janë djegur, por mua më shkante mendja tek gruaja ime dhe të Hysnija. Do ishte parandaluar kjo ngjarje nëse policia do kishte arrestuar Hysnijën për grabitjen e lekëve. Unë dua pafajësi tani që kam 3 javë që kam dalë nga burgju", ka thënë Zambak Hoxhallari.

### Prokurori Elision Sadiku në 'sitën' e vetingut, KPK: Nuk justifikon klinikën e gruas

TIRANË - Prokurori i Prokurorisë së Korçës, Elision Sadiku ka dalë dje në seancën dëgjimore para KPK-së për t'iu nënshtruar vetingut. Sipas komisionit, duke iu referuar raportit të përcjellë nga ILDKPKI, prokurori ka bërë deklarim të saktë dhe ka burime të ligjshme të pasurisë, nuk ka fshetje apo deklarim të rremë. "Prokurori është bashkëpronar 1/8 i një trualli familjar 16 mijë m2. Në vitin 2013 ka bërë blerje pajisjesh dentare për bashkëshorten në vlerën 7 mijë euro. Ka apartament 27 mijë euro Korçë. Automjet "Peugeot" 400 mijë lekë. Nga analiza e provave rezultoi se në deklarimet e vitit 2008 bashkëshortja e tij deklaroi një dhuratë nga babai për fejesë 34 mijë euro duke paguar fillimisht 27 mijë euro. Më tej është bërë anulim i kontratës dhe është lidhur kontratë për një apartament tjetër", - thuhet në raportin e KPK. Ndërkaq, KPK shprehet se nuk rezultoi e provuar që bashkëshortja të ketë qenë e punësuar dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pajisjeve të klinikës dentare 7500 euro. Ndërsa, sa i përket figurës, prokurori Elision Sadiku nuk ka dyshime për kontakte të papërshtatshme dhe rezultoni i pastër.

## Vlorë, sekuestrohen dy gomone me vlerë 42 mijë euro

**P**olicia e Vlorës, në vijim të punës për evidentimin dhe ndëshkimin e shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" ka sekuestruar dje dy mjete lundruese. Bëhet fjalë për gomonen 7.4 m e gjatë dhe me vlerë tregu 12.000 euro, në pronësi të 32-vjeçarit G.M., banues në Vlorë si dhe për gomonen 10 m të gjatë, me vlerë tregu 30.000 euro, në pronësi të shtetasit A.V., 50 vjeç, banues po në Vlorë. Materialet hetimore iu referuan prokurorisë së qytetit bregdetar.



## Tentoi të ikte në Greqi me pasaportë false, prangoset i "forti" i Shkodrës, Lulzim Kulla

**GJIROKASTËR** - Policia Kufitare e Gjirokastrës ka arrestuar dje në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës biznesmenin shkodran, Lulzim Kulla, i cili më 13 janar të këtij viti i shpëtoi mrekullisht një atentat me tritol. Në ngjarjen e rëndë të ndodhur në qendër të qytetit verior, mbetën të plagosur 7 persona si dhe ai vetë. Ndërkohë, dje burime nga blutë e Gjirokastrës bënë

me dije se 43-vjeçari (njihet si i "forti" i Shkodrës) u ndalua, pasi tentoi të kalojë kufirin me pasaportë të falsifikuar me të dhëna të rreme. Mësohet se prokuroria e Durrësit, më datë 25 korrik të 2014-ës ka nxjerrë urdhër për bllokimin e kësaj pasaporte si dhe poseduesit të saj. Kulla u shoqërua për veprime të mëtejshme në policinë e Durrësit.

## Kreu i Ujësjellësit Mark Molla: Kolektorët kanë qenë të hapur

# Përmbytja e spitalit nga reshjet, drejtoresha: Shkak bllokimi i kolektorëve

## "Nuk ka asnjë pajisje të dëmtuar"

SHKODËR

**R**eshjet e dendura të shiut përmbytën të hënën reparatin e imazherisë dhe atë të fizioterapisë në spitalin rajonal të Shkodrës. Vërshimi i ujit krijoi një panik te pacientët dhe qytetarët e qytetit verior. Pas përmbytjes ka reaguar drejtoresha e këtij institucioni shëndetësor, Teuta Rrjollli. Ajo deklaroi se përmbytja erdhi si shkak i bllokimit të kolektorëve të ujerave jashtë mjediseve të spitalit. "Nuk ka asnjë nevojë që të ketë panik tek qytetarët apo pacientët. Gjithçka funksionon normalisht në spital. Përmbytja nuk erdhi si shkak i ndonjë problemi të spitalit të Shkodrës, por ka ardhur për shkak të bllokimit të kolektorëve. I gjithë stafi i spitalit është vënë në gatishmëri duke u munduar që të largojnë ujin. Prezencë uji ka patur tek reparti i imazherisë dhe fizioterapisë. Teknikët më raportuan se përmbytja u shkaktoi, pasi kolektorët e jashtëm kanë qenë të bllokuar. Sasia e madhe e ujit, por edhe papastërtitë nga qeset plastike apo mbetje të tjera kanë bërë që të ketë çarje të tubave dhe më pas uji të përfundojë në mjediset e spitalit. Megjithatë në jemi angazhuar me të gjitha forcat tona duke e stabilizuar situatën", u shpreh Rrjollli.



Drejtori i Ujësjellësit në Shkodër, Mark Molla



Drejtoresha e spitalit, Teuta Rrjollli



Përmbytja e spitalit në Shkodër

### AKUZAT E DEPUTETIT SPAHIA

Ai që akuzoi në mënyrë direkte për situatën e krijuar në spitalin e Shkodrës është deputeti i PD-së, Bardh Spahia. Pasi takoi për 40 minuta disa prej mjekëve të këtij spitali, Spahia akuzoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe qeverinë për atë situatë në spitalin e Shkodrës. "Përmbytja nuk ka ardhur nga kolektorët, sepse uji është futur nga pjesa e sipërme e ndërtesës dhe nuk ka buruar nga poshtë ku janë kolektorët. Kjo do të thotë se përmbytja në spital ka ardhur për shkak të infrastrukturës së dobët atje", -tha ndër të tjera deputeti.

### DREJTORESHA E SPITALIT

Teuta Rrjollli sqaroi se në spitalin rajonal të Shkodrës nuk ka asnjë pajisje të dëmtuar apo jashtë funksionit. Sipas saj, menjëherë pas pushimit të reshjeve të shiut është punuar maksimalisht që të largohet uji, në mënyrë që dy repartet të jenë në gatishmëri. "Fizioterapia ndodhet një kat nëntokë dhe ka patur edhe më përpara përmbytje ndërsa për imazherinë është hera e parë që përmbytet. Për repartin e imazherisë po mendohet që të krijohet një rrugë e dytë e kalimit të ujit

në rast se kolektorët bllokohen sërish, në mënyrë që nëse ka sërish reshje aq të dendura shiu ai repart të mos përmbytet. Sa i përket repartit të fizioterapisë, i cili është në nëntokë, gjithnjë mbetet i rrezikuar në rastet kur ka reshje të dendura shiu. Ashtu është ndërtuar që në fillim dhe momentalisht nuk kemi një zgjidhje", u shpreh drejtoresha e spitalit të Shkodrës.

### KREU I UJËSJELLËSIT

Ndryshe mendon drejtori i Ujësjellës-Kanalizimeve në Shkodër, Mark Molla. Sipas këtij të fundit, nuk është e


vërtetë se përmbytja në spitalin e Shkodrës ka ardhur si shkak i bllokimit të kolektorëve.

Molla tha për "GSH" se kolektorët kanë qenë në funksion dhe se për të bërë të mundur kalimin e ujit edhe me shpejtësi më të madhe janë hapur edhe pusetat. Sipas tij kanalizimet dhe kolektorët kanë funksionuar normalisht. "Në 1 orë e 45 minuta pati reshje shiu aq sa për 24 orë me radhë. Qenë shumë të dendura, duke bërë që rrugët dhe trotuarët të bllokohen, gjë e cila besoj është normale për aq shi sa ra në aq pak kohë. Megjith-

atë ne u angazhuam maksimalisht me të gjithë punonjësit në mënyrë që të bënim largimin sa më parë të ujit. Sa i përket spitalit të Shkodrës nuk është e vërtetë se përmbytja atje ka ardhur për shkak të bllokimit të kolektorëve të ujit. Kolektorët kanë funksionuar dhe s'kanë qenë të bllokuar për asnjë moment. Tek spitali kanë funksionuar qoftë kanalizimet, por edhe kolektorët. Nuk e di arsyeve të përmbytjes në spital. Për më gjatë pyesni drejtuesit e këtij institucioni pse janë përmbytur", -pohoi drejtori Mark Molla.

## Shkon për gjykim dosja për ish-administratorin e Villaznisë dhe financierin

**SHKODËR** - Prokuroria e Shkodrës mori të pandehur dhe dërgoi për gjykim ish-administratorët e klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a si dhe financierin e këtij klubi. Për ta u ngrit akuzë për shpërdorim detyre, shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë, dhe shpërdorim i fondëve publike duke i shkakuar shtetit një dëm ekonomik, me vlerë prej afro 30 000 000 lekësh. Konkretisht bëhet fjalë për shtetasit: Fatos Gjyrezi, administrator i shoqërisë nga data 1 shtator 2012 deri në datën 12 gusht 2014; Neritan Kalamishi, administrator i shoqërisë nga data 12 gusht 2014 deri në datën 8 janar 2016 dhe Denis Fani financier i shoqërisë. Gjithashtu, ndaj këtyre shtetasve ka filluar procedimi penal për pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.



### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

#### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPËRFAQE 103 M2, ZONAKADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.  
**ÇMIMI 12.016.000 LEKË.** - Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.08.2018.  
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

### Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

"Apartament", me sip. 69.2 m2. Nr pasurie 10/158+2-1, të ndodhur në Zonen Kadastrale Nr. 8631, Vol. 9, Faqe 80, me adresë Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1. Prona është e regjistruar pranë Z.V.R.P.P Lezhe, me emer të Lulzim Kros Beqiri. Çmimi fillestar për shitje është 3.100.000 Leke.  
**Data e shpalljes 05.07.2018**  
**Data e zhvillimit 31.07.2018 deri në orën 16.00**  
 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzojnë përfituesit

Dosjet e viteve 1997-1998, formulari për të marrë paratë

Lista me 3260 pronarët në të gjithë vendin

Pronarët që aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1997 dhe 1998, për të cilët ka një vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës duhet të plotësojnë formularin-tip për të marrë paratë. Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin dhe dokumentet që duhet të plotësojnë rreth 3260 përfitues në të gjithë vendin për të marrë kompensimin në para ose kompensim fizik. Për dosjet e vitit 1887 janë 1460 pronarë dhe dosjet e vitit 1998 janë 1800 pronarë.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip mësohet se kërkuesi, duket të cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës vërtetim nga gjykata, nëse vendimi përfundimtar i apo vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në

rugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokuror e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numer logarrie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandati pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 mil-

ionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësura financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave

thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

PAGESAT E PËRSHPEJTUARA

Pronarët mund të përfitojnë edhe pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së futurës, për pagesën bre-

nda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit, dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për

kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese, të cilat shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

DOSJET E VITEVE 1997-1998

DOSJET E VITEVE 1998

Bashkia Emri (Subjekti Kerkues) VLERESIMI
Kolonjë Petro Luarasi 505,326
Kolonjë Feta Ypi 2,053,740
Kolonjë Hysen Shaka 337,781
Kolonjë Jani Papandile 1,914,795
Kolonjë Xhevahir Karamani 617,388
Skrapar Xhevahir Karamani 617,388
1,251,040
Skrapar 394,781
Skrapar Haki Sanxhaku 5,302,408
Përmet Afroviti Shana 785,636
Përmet Apostol Adhami 207,829
Përmet Foti Jani 98,895
Përmet Sabri Rapo 113,390
Përmet Ylmi Mersini 242,389
Përmet Kleanthi Nape 75,625
Përmet Elefteri Ballabani 397,141
Përmet Kalam Teta 505,889
Përmet Niko Zhaka 43,474
Përmet Adhurim Male 5,824,000
Përmet Mahide Sado 727,167
Përmet Shpresa Morreku 2,766,049
Përmet Ibrahim Abazi 416,909
Përmet Vangjeli Thomollari 280,396
Përmet Kolicë Ballabani 35,292
Durrës Dhimitër Beshiri 512,109
Durrës Ibrahim Gustina
Durrës Nexhmedin Kau 5,824,312
Mallakastër Astrit Dinaj 918,342
Berat Sazan Hysni Behari 1,492,316
Ura Vajguore Hekuran Abas
Sulejmani 2,530,072
Berat 2,672,079
Poliçan Xhemil Hekuran Jahollari 563,200
Berat Engjëllushe Maska 1,606,423
Lezhë Albert Marku 4,017,192
Lezhë Sandër Mark Skandaj
Peqin FATOS PALLUQI 3,504,476
Lezhë Sait Kolaj 373,367
Lezhë Preng Geg Nikollë 1,882,815
Kupovë Refat Oboni 2,686,233
Kupovë Fik Otoni 1,316,407
Vau i Dejës Nise Nilot Curri
Shkodër Berhan Pacrami 7,149,240
Fier Lili Ikonomi 2,863,682
Kolonjë Feridan Memu 1,967,307
Shkodër Sal Burreçi 1,904,708
Konispol Hekuran Besho -11,901,000
Konispol Kostandin Koço 53,324
Memaliaj Bekim Zace -3,748,000
Pogradec Margarita Angjo 136,135
Pogradec Petraq Pojanaku
Pogradec Joan Io 52,863
Pogradec Sotirraq Mile 103,386
Pogradec Durim Çorbaxhi 156,912
Kurbini Javer Hoti 10,287,375

Rrogozhinë Hafsa Cara 1,383,447
Pogradec Spiro Bice 194,734
Bulqizë ZENEL SPAHUI
Klos Lirim Llana 886,675
Gramsh AGIM HOXHA 1,040,365
Gramsh SELMAN MERZHEKU
783,151
Gramsh 715,595
Gramsh SERVET MATO 150,125
Mallakastër Rapo Hazzija 487,659
Mallakastër Dine Hazzija 1,100,954
Mallakastër Rapo Hazzija 750,624
Durrës Liri Pallushka
Skrapar ISMAIL ZENOLLARI 713,792
Skrapar ISMAIL ZENOLLARI 3,699,603
Skrapar Astrit Fejzo 305,140
Skrapar 32,996
Tropojë Zolë Zeqir Mula 581,084
Tropojë Sherif Mustaf Rrustemaj 18,474
Tropojë Ibi Shpend Ponari 285,220
Tropojë Ibi Shpend Ponari 184,949
Tropojë Ibi Shpend Ponari 252,232
Tropojë Ibi Shpend Ponari 38,414
Tropojë Ibi Shpend Ponari 285,220
Tropojë Ibi Shpend Ponari 252,232
Vau i Dejës Ymer Velia 1,316,414
Vau i Dejës Dan Hasani 519,054
Shkodër Pjeter Prelush Preka
Shkodër Palok Marku 3,953,948
Shkodër Ulan Aga Dedia 1,001,358
Poliçan Hida Abedin Mance 3,038,187
Memaliaj Faik Haki Velzi 227,464
Memaliaj Zana Beqiri 2,317,013
Ura Vajguore Tomorr Thoma Kumaraku 1,794,306
Ura Vajguore Lili Kristo Koraçe 883,240
Shkodër Ujkan Smajl Bruçi 1,294,860
Durrës Xhavit Rama 10,871,211
Skrapar 345,296
Skrapar 353,774
Skrapar Qerim Gjo 20,810
Bulqizë ALEKSANDER BODINI 856,827
Skrapar Hetem Duocillari 380,381
Maliq Skender Avdyllari 981,370
Korçë Nasi Strati 627,915
Korçë Spiro Orgoeca 550,000
Korçë Pandeli Mano 1,081,208
Tiranë ZYDI SARAÇI 237,237
Tiranë FETAH KRUTANI
Tiranë MYRJE SHEHI 1,786,629
Korçë Dhimitra Nikolla 587,890
Korçë Muarek Pesti 19,987
Korçë Elsa Postoli 220,126
Korçë Ilo Kuneshta 768,308
Maliq Mamudi Piasa 80,929

Maliq Lumturie Mullaçmeri 844,412
Maliq Nuri Toska 235,110
Përmet Avdul Zaimi 1,180,001
Tepelenë Hajri Cacaj 2,803,989
Tepelenë Foto Kapaj 2,892,625
Shijak Shaqir Alushi
Shijak Bihane Llafiu 1,610,250
Durrës Bejta Mesuti
Tepelenë Hito Lopaj 282,856
Gramsh
Gramsh ISUF KOÇI
Kuçovë Ibrahim Haznedari 1,022,970
Korçë Ymeri Nurçelli 4,790,000
Korçë Dhimitraq Postoli 1,261,308
Korçë Ali Kodra 388,805
Korçë Rexhep Kodra 1,675,000
Maliq Xhafer Qose 1,363,434
Korçë Bashkim Islami 361,588
Maliq Xheol Agolli 187,690
Maliq 1,530,000
Maliq Hyseni Nikollë 680,000
Maliq Nisneta Zguro 2,571,686
Maliq Shaban Demirçiri -76,500
Vorë HYSEN ,EMINE ÇEKA
Kamëz SHIRE DOSIA 1,128,378
Sarandë Vesil dhe Filip Mërkuri
Divjakë Shahn Muça 31,688,000
Divjakë Behar Dybelli 18,200,000
Divjakë Vangjel Ndoni 6,521,055
Divjakë Ylvi Lecini 25,480,000
Divjakë Agim Rredhi 13,880,048
Tepelenë 179,785
Memaliaj Kastriot Agaraj 9,925,719
Tepelenë Llukan Kuri 230,994
Memaliaj SULO HYSENI 4,296,623
Tropojë Sabrie Mustaf Haxhia 27,076
Lushnjë Rita Nko 40,768,000
Vau i Dejës Sabri Shah Abdullai 0
Shijak Petrit Koçi -754,884
Elbasan SEFEDIN TRUNGU 71,230
Korçë Hysen Keli 1,144,564
Skrapar Qerim Hoxha 44,395
Skrapar Qerim Hoxha 1,621,530
Skrapar Islam Levenshiti 2,872,431
Skrapar Islam Levenshiti
Pogradec Bukurije Zeka
Pogradec 0
Pogradec Bardhyli Filip Papajani 7,941,687
Lezhë Shyqyri Todhja 1,148,985
Memaliaj Shyqyri Velaj 8,902,163
Memaliaj Salin Manaj 412,875
Lezhë Hasan Myrteza Dema 4,851,270
Krujë Idriz Xuka 191,220
Memaliaj Ylli Likaj 187,323
Krujë Shefqet Ajazi 4,126,762
Krujë 689,011
Krujë Rexhep Hoxha -10,167,337

Memaliaj Halim Shehaj 2,011,349
Tepelenë Zilo Bailli 291,374
Korçë Koço Ropi 750,479
Korçë Mbarime Koshena 334,506
Maliq KOSTIRKA ÇYFKEU 944,414
Korçë 57,344
Korçë Ili Teneqexhiu 0
Korçë Vangjel andoni -40,339,600
Korçë -29,479,500
Lezhë Vicens Pjeter Cali 216,531
Tepelenë Cane Lamaj 274,295
Mallakastër Muco Shehu 916,163
Mallakastër Luan Nuhaj 1,316,874
Tepelenë Myftar Sefar Mati 313,387
Memaliaj Hano Mullaçari 107,942
Tepelenë 3,855,285
Lezhë Ndrek Prendi 1,065,485
Lezhë Leonard Bira 2,577,388
Librazhd Demir Kala
Sarandë Kadri Haxhi
Kupovë Qerime Hasani 372,735
Përmet Stefanag Joanidhi 70,342
Përmet Nonda Buxhuku 669,011
Përmet Luan Lushnja 160,880
Përmet Dhimitraq Shyti 448,885
Memaliaj Muhamet Liaka 2,809,230
Tepelenë 439,636
Tepelenë Mehmet Rexhaj 12,768,000
Shijak Emin Gjeçi 3,167,996
Lezhë Bardhok Gega 710,000
Droplull Aretii Pananajtji
Gjirokastrë Effialia Cabelli
Gjirokastrë Lilit Shupo
Gjirokastrë Higmët Xheko
Tepelenë Daut Dautaj 300,274
Tepelenë Shaqe Barjamaj 203,042
Memaliaj Refat Qazim Lamaj 324,105
Tepelenë Tefik Hyseni 2,171,565
Tepelenë Andrea Mati 4,316,000
Lezhë Ilvi Dervishi 1,009,575
Korçë Robert Ngjela 311,456
Korçë Kostia Kovaci 356,217
Korçë Ollga Gjoni 504,841
Korçë -17,211,000
Korçë -15,420,570
Maliq Koci Prifti 405,942
Korçë Hasan Kodra 3,837,416
Pogradec Sotirraq Mato 56,503
Maliq Vanci Marko 1,258,534
Memaliaj Myrto BARKAJ 2,075,625
Tepelenë 720,565
Memaliaj Bato Kanandaj 972,776
Selenicë Shezai Kodra 219,248
Selenicë Kostandin Sadikaj 399,412
Vlorë Qemal Qemali 6,297,594
Himarë Avni Veshi 276,443
Selenicë Dede Meçaj 84,839
Vlorë Daut Shitino 5,539,766
Vlorë Liaz Rungaja 2,818,330

Vlorë Them Doko 2,164,985
Vlorë Pandeli Koçi 3,100,584
Selenicë Janul Çuka 2,876,663
Vlorë Mezin Gilva 477,394
Selenicë Ferjat Teiharaj 1,858,991
Selenicë Remzi Mataj 2,065,330
Himarë Enver Galloshi 88,652
Himarë Nako Jovani 141,081
Vlorë 585,989
Vlorë Ferjat Llanaj 730,436
Vlorë Janaq Saraci 320,846
Selenicë Emrulla Nivica 5,775,496
Selenicë Ismet Manaj 354,832
Selenicë Qani Allaj 3,170,094
Himarë Agif Thomaraj 14,299
Himarë Lirim Abazaj 55,289
Himarë 276,443
Selenicë Bektash Brahimi 820,753
Selenicë Teki Celaj 322,445
Selenicë Hamdi Hasani 1,258,385
Selenicë Ibrahim Gorgaj 2,195,728
Selenicë Leter Hitaj 2,475,375
Vlorë Paskal Doko 530,960
Selenicë Perlat Hoxha 138,221
Selenicë Tema Celaj 4,667,850
Himarë Minella Mërkuri 113,435
Himarë Vanisha Varfi 151,751
Himarë Vasil Gjikondi 742,603
Selenicë Xheqir Gjeçi 1,546,418
Selenicë Artiz Tahiraj 296,123
Vlorë Hasan Bonjaku 3,796,125
Vlorë Zyk Laze 697,410
Selenicë Liljana Maliq 2,356,557
Selenicë Skender Demiraj 155,380
Selenicë Piro Rexhepi 2,152,869
Selenicë Razzie Agaj 103,904
Selenicë Arjan Mehmetaj 2,339,880
Selenicë Kalemë Nelaj 138,068
Himarë Sofi Ndreka 246,769
Himarë Elpinqi Konomi 173,061
Himarë 254,994
Vlorë Pellumb Bimo 6,406,347
Himarë Ksenofon Balta 141,152
Elbasan NAUN DOKA
Lushnjë Reshat Mëbelli 52,780,000
Lushnjë Themë Mëhillika 6,532,000
Lushnjë Aleksandra Daja 54,236,000
Memaliaj Sulo Hasanbeqa 891,273
Memaliaj Sulo Meta 1,618,886
Tepelenë Servet Shehu 1,019,978
Shkodër Tahir Haxhi Dergjini 559,650
Shkodër Lutij Marku 30,128,940
Memaliaj Sabri Nuraj 2,453,666
Memaliaj 60,055
Vlorë Arriz Pal Marku Gjopjetri 0
Fushë Arriz Ndue Marku 0
Fushë Arriz Gjon Prel Luta 1,376,085
Korçë Ramadan Kocbelli 998,145
Korçë Petraq Minka 682,625

Korçë Celike Myrtollari 724,540
Korçë Jorgjia Strati 46,471
Korçë 850,000
Korçë Sotirraq Premti 253,088
Maliq Avni Cenolli 95,752
Durrës Nihat Kurti 0
Fier Bajram Tona 10,193,568
Tepelenë Shpetim Spahiaj 4,098,975
Devoll Ferit Nake 0
Tepelenë Haseni Xhaka 552,455
Memaliaj Pasho Durmish Lisi 585,326
Ura Vajguore Fie Ramadan Cëla 4,731,984
Ura Vajguore Xhevahir Tofik
Mordari 1,452,938
Berat 2,697,698
Ura Vajguore Fitim Dervish Bega 6,684,229
Ura Vajguore Ilir Vangjel Naska 493,538
Tropojë Remzi Lici 4,704,000
Tropojë Sabrie Mustaf Haxhia 29,875
Memaliaj Hasim Hadaj 400,596
Ura Vajguore Llambi Mitro Keri 1,920,513
Dibër BAJRAM KUCKA -9,793,110
Dibër LIRIM KABXHU (KAPXHU) 1,567,020
Shijak Mustafa Kërtalli 440,200
Vlorë Godiva Shyti
Maliq Julian Emanuel 3,674,318
Korçë 508,528
Korçë 30,504
Korçë 456,029
Maliq Nasibi Asim Agolli 380,024
Maliq Bajram Arif Kroj 3,551,625
Korçë Vangjel Luarasi
Korçë Gjinovefa Viso
Korçë Ilir Burbuçi 67,470,800
Korçë Stavri Qirjako 302,180
Korçë Irakli Piri 978,849
Maliq Ili Lihmani 562,725
Skrapar Muço Jace 3,130,043
Korçë Shaban Caka
Skrapar Shaban Caka 332,315
Skrapar Tahir Mersini 43,588
Skrapar Riza Kushova 405,131
Skrapar Shpresa Shamo 559,343
Skrapar Ali Cufë 253,249
Tiranë MBUKURIE TARJA 842,400
Kukës Bislim Ceka 2,977,996
Kukës Aslan Alimet 258,300
Lezhë Dila Bardhi
Shkodër Trashigintaret Malevja 810,000
Shkodër Jonuz Malevja 32,154,000
Shkodër Hysen Hala Viza 172,574
Krujë Bajram Goci
Korçë Gago Muli 1,610,800

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



BLLOKIMI I VESHIT NGA NOTI, PSE NDODH DHE ÇFARË DUHET TË BËNI

# SUMMER

*pages*

SUPLEMENT I GAZETË SIKRITARE

E mërkurë 25 Korrik 2018



MODELJA E  
NJOHUR

**Oriola Marashi**  
**'zhgënjen' fansat**



**Era Istrefi nuk di të ndalet,**  
**ja çfarë ka bërë këngëtarja**

**BULEVARDI**  
**POLITIK**



- Deputeti i PS publikon dëftesën e vajzës gjimnaziste: Më bën krenar, më bën të reflektoj...
- Deputeti i PS rrëfen historinë e zv.ministrit të Ramës: Kërkoj t'i paguhej forcërisht dreka
- Dash Shehi rrëfen kush është femra më e bukur në parlament
- Reagimi i Melania Trump kur i dha dorën Putinit po bën xhiron e Botës



Refehohet moderatorja: Sfidat e mia si 'timonhhiere' në punë dhe

## RUDINA DEMBAÇAJ:

# Ja çfarë nuk më lë në dorë bashkëshorti

*"Kokteili me emrin tim do ishte pikant"*

**Rrëfihet moderatorja: Sfidat e mia si 'timoniere' në punë dhe familje**

# Rudina Dembacaj:

## Ja çfarë nuk më lë në dorë bashkëshorti

*"Kokteili me emrin tim do ishte pikant"*

**Egla Xhemali**

Ajo është drejtuese e një emisioni argëtues dhe me plot humor. Personazhe të njohur nga të gjitha fushat hipin në taksinë e saj për të dhuruar argëtim. Rudina Dembacaj është një nga figurat më të dashura për publikun. Këtë herë moderatorja vjen në një rrëfim ekskluziv për suplementin "Summer Pages", për të na zbuluar të fshehtat e 'timonieres' në punë dhe në familje, pasionet e saj, si dhe përzgjedhjen e veshjeve që ka bërë për pushime. Rudina pohon se personazhet që ka pasur të ftuar në taksia nuk u kanë bërë bisht pyetjeve dhe se nuk e ka cenuar kurrë privatesinë dhe personalitetin e tyre. Në familje fuqitë e moderatorës harmonizohen bukur mes guximit, ekspresivitetit dhe jo rrallëherë aventurës. Dembacaj thotë se bashkëshorti nuk i lë asnjëherë në dorë të paguajë dritat, ujin apo të ngasë makinën në udhëtimet e gjata. Rudina tregon se nuk hyn te njerëzit kursitarë. Një pasion që Rudina ka bindje se e bën në mënyrë perfekte është rrepimi. Ngjyrat e shpirtit ajo i reflekton në të qenurit solarë me të gjithë. Kokteili që do mbante emrin e saj natyrisht që do



ishte pikant. Së fundmi, moderatorja ndan me ne përzgjedhjen e veshjeve që do marrë me pushime, ku mes tyre nuk mungojnë takat dhe vathët që janë dashuritë e saj. **Cili nga personazhet u ka bërë bisht pyetjeve tuaja?** Personazhet që kam pasur të taksia ime nuk është se u kanë bërë ndon-

jëherë bisht pyetjeve edhe rrallë ndonjëri prej tyre mi ka kërkuar pyetjet përpara, po ka qenë shumë e rrallë.

**Deri ku keni guxuar me pyetjet dhe me kë?**

Gjithmonë kam guxuar me pyetjet deri në atë pikë ku nuk cenohet privatesia dhe personaliteti i askujt.

**Cila ka qenë pjesa më e sikletshme me taksistët në Shqipëri?**

Taksistët në Shqipëri janë të gjithë fantastikë, të japin muhabet dhe nuk merrtesh sado rrugë të kesh me ta. Të them të drejtën, për fatin tonë të keq, shumë njerëz të zanateve dhe të profesionerve të ndryshme janë të pakënaqur, po sidomos taksistët kanë gjithmonë një arsye për t'u ankuar edhe kjo i karakterizon, i bën ata shumë të këndshëm.

**Çfarë lloj 'timoniereje' jeni në familjen tuaj?**

Në familje them se jam një 'timoniere' e guximshme, ekspresive,

shpeshherë dhe aventuriere.

**Dicka që bashkëshorti nuk ta lë kurrë në dorë?**

Bashkëshorti nuk më lë kurrë në dorë të ngas makinën në udhëtimet e gjata, nuk më lë kurrë në dorë që të paguaj dritat dhe ujin.(qesh)

**Cili është ai ves që e keni nga fëmijëria?**

Nga fëmijëria nuk do thosha se kam ndonjë ves. Vesi dhe fëmijëria nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, po ne si familje e madhe që mbajmë të gjithë mbiemrin Dembacaj kemi disa karakteristika shumë interesante dhe shpeshherë për shembull,

kur dalim para pasqyrës, i themi vetes "O Zot i madh, çfarë mrekullie që ke bërë". Këtë e kemi të gjithë. Nëse je Dembacaj, del para pasqyre dhe lavdëron veten.

**Çfarë nuk gjen asnjëherë në shtëpinë tuaj?**

Në shtëpinë time nuk gjen dot kurrë vaj luledielli dhe mami im kur vjen dhe do të gatujë ndonjë gjë me të, që nuk bëhet me vaj ulliri, gjithmonë ankohet.

**Për çfarë nuk kursesh asnjëherë?** Të them të drejtën, nuk është se hyj te njerëzit shumë kursitarë, po nuk do kurseja kurrë për Viktorian sigurisht.

**Një pasion që nuk e ke bërë shumë publik?**

Pasioni që nuk para e kam bërë publik është rrepimi. Unë mendoj që rrepoj shumë bukur.

**Çfarë lexon qartë dikush tek ju?**

Tek unë lexohet shumë qartë se sa shumë e dua jetën dhe sa më pëlqen ta jetoj në çdo detaj.

**Një lloj kokteili që do kishte emrin tuaj, me çfarë shije do ishte?**

Kokteili që do kishte emrin tim do ishte pikant sigurisht.

**Aventura më e çmendur verore që keni patur ndonjëherë?**

Singerisht nuk kujtoj aventura të çmendur verore.

**Çfarë veshjeesh keni marrë me vete për pushime?**

U përpoqa t'i ndaj rrobrot në proporcion të drejtë, duke qenë se kam palën e kafart të pushimeve për të bërë, megjithatë jam munduar maksimalisht që të kem gjëra sa më të rehatshme, sa më të lirshme. Sigurisht që nuk mungojnë takat dhe vathët, që janë dashuria ime, sidomos vathët një herë.



## Oriola Marashi 'zhgënjen' fansat

**M**odelja Oriola Marashi është treguar mjaft e rezervuar me postimet e saj kohët e fundit. Ndërkohë që të gjithë presin ndonjë 'çudi prej saj', bukuroshja ka prerë hovin e atyre që e ndjekin. 'E di që doni foto plazhi, po për momentin ...' ka shkruar ajo krahas fotos, ku shfaqet me fustan nusërie. Ndërkohë është gjithë vera para dhe modelja seksi ka mjaftueshëm kohë të ndezë rrjetet sociale.



## Klaudia Pepa bën lëvizjen e radhës

**A**jo kishte zgjedhur një body, e cila nga pas kishte formën e tangave. Kaq mjaftoi që komentuesit të shpërthenin ndaj saj. Pas zhurmës që u bë në rrjetet sociale, ajo ka vendosur që foto e tjera të jenë më 'normale', me këtë veprim të balerines janë qetësuar dhe fansat e saj. Pepa gjithmonë është diskutuar për postimet e fotove, që janë quajtur gjithmonë tejet provokuese.




## Era Istrefi nuk di të ndalet, ja çfarë ka bërë këngëtarja

**P**as "Live it up" dhe "Prisoner", Era Istrefi nuk ka ndërmend të ndalet. Performanca e saj në "Rusi 2018" ishte një sukses i jashtëzakonshëm, por Era tashmë do të sjellë një bashkëpunim të ri që nuk e prisim. Këngëtarja e njohur shqiptare përmes një postimi në rrjetin social "Instagram" i ka lajmëruar të gjithë se kjo verë nuk do të jetë për pushime, por për punë. Kënga e re titullohet "Oh God" (Oh Zot) dhe do të jetë në bashkëpunim me këngëtarin Koshens. Fansat e bukuroshes mezi po e presin daljen e këngës. Era ka marrë mjaft komente pozitive për këtë projekt, që mesa duket pritet të jetë një tjetër sukses i saj.



## Alba Hoxha bën blerjen që i mahniti të gjithë

**K**oreografi i njohur Albi Nako dhe balerina Alba Hoxha kanë qenë një nga dyshet më të komentuar muajt e fundit dhe kjo pasi është përfolur gjatë se mes tyre ka një lidhje dashurie. Ndonëse ata nuk kanë pranuar asgjë, burime pranë çiftit kanë treguar se janë në prag të fejesës. Mirëpo Alba vazhdimisht e mohon lidhjen me koreografin e njohur, ndonëse janë kapur shumë herë nën shoqërinë e njëri-tjetrit. Ndonëse Alba ka treguar se është beqare, postimi i fundit ka ngritur dyshime tek ndjekësit. Ajo ka publikuar një foto në "Instagram", ku shfaqet në një argjendari duke mbajtur në dorë një unazë e fejesë. "Unazën e gjeta, por më mungon..." ka shkruar balerina pranë fotos me humor.



**N**oti është një nga arsyet kryesore që veshi bëhet një pre e lehtë e infeksioneve.

Një nga problemet më të përhapura gjatë stinës së verës është infeksioni dhe bllokimi i veshit që prek jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit. Infeksioni shfaqet brenda kanalit të veshit kur ka çarje të shtresës mbrojtëse që përbëhet nga dylli.

Një gjë e tillë lehtëson futjen e baktereve, mykut apo virusëve nën lëkurë. Tani do ju njohim me faktorët e rrezikut të infeksionit të veshit dhe si t'i shmangni ato.

**NOTI OSE LAGESHTIA E TEPËRT**

Noti i shpeshtë dhe i vazhdueshëm apo futja e ujit në vesh mund të zbusë lëkurën e kanalit të veshit.

Lagështia prish ekuilibrat e baktereve të shëndetshme që jetojnë në këtë zonë.

**ÇFARË DUHET TË BËNI**

Në këto raste duhet të përdorni tapa veshi ose sigurohuni që të thani veshët duke e mbajtur kokën mënjanë deri sa uji të dalë nga veshi.

Për një përtharje më të mirë përdorni edhe tharësen e flokut në distancë nga veshi. Mund të përdorni edhe pambuk të lyer me pak vaj ulliri në vend të tapave të veshit kur hyni në ujë për not.

**PASTRIMI OSE GËRVISHTJA E KANALIT TË VESHIT**

Pastrimi i kanalit të veshit heq edhe dyllin mbrojtës të tij.

Përdorimi i gishtave, kunjave prej pambuku e të tjerë e dëmton rëndë lëkurën. Ekspertët thonë se në kanalën e veshit nuk duhet futur asnjë send, sado i vogël të jetë.

**FUTJA E SENDEVE NË VESH**

Përdorimi afatgjatë i kufjeve, aparateve të dëgjimit, tapave e çdo sendi tjetër e dëmton lëkurën e veshit.


Nëse përdorni aparat dëgjimi, atëherë duhet ta pastroni çdo mbrëmje. Kufjet nuk duhen mbajtur për shumë gjatë në vesh, sepse jo vetëm që dëmtojnë dëgjimin, por edhe kanalën e veshit.

**PROBLEMET ME LËKURËN**  
Psoriaza apo ekzema që shfaqet në lëkurën e kanalit të veshit nxit infeksionin.

Reagimet alergjike që mund të shfaqen në vesh ndodhin si pa-



# Bllokimi i veshit nga noti, pse ndodh dhe çfarë duhet të bëni



sojë e përdorimit të produkteve si llaku, shampo, vathe apo medikamente.


Nëse ju kruhet veshi, atëherë konsultohuni me një mjek për të diagnostikuar problemin.

Infeksioni në pjesën e jashtme të veshit mund të evitohet duke folur me mjekun, i cili mund t'ju japë solucione me pika ose të ofrojë trajtime për pastrimin e veshit.



### Deputeti i PS publikon dëftesën e vajzës gjimnaziste: Më bën krenar, më bën të reflektoj...

Deputeti i PS, Ulsi Manja, publikon në rrjetin social dëftesën e vajzës së tij, Sonora. Vajza e Manjës është gjimnaziste të "Qemal Stafa" dhe ka përfunduar klasën e dhjetë me mesatare 10. "Si çdo prind, kjo dëftese notash e vajzës sime më bën krenar, më çlodh mendjen dhe më bën të reflektoj pozitivisht për të bërë më të mirën për Shqipërinë e fëmijëve tanë!", shkruan ndërkaq deputeti i PS, bashkangjitur dëftesës.



### Deputeti i PS rrëfen historinë e zv.ministrit të Ramës: Kërkoj t'i paguhej forcërisht dreka

Një histori e sikletshme kjo dhe që po komentohet së tepërmi në profilin e Pjerin Ndreut, deputetit të PS, i cili e ka ndarë me miqtë e tij. Ndreu rrëfen se si një zv.ministër i qeverisë 'Rama', i cili kishte shkuar në një restorant të "Rana e Hedhun" është befusuar kur kamerieri i ka kërkuar të bente pagesën e faturës. Ish-zv.ministri, siç shkruan Pjerin Ndreu është i një force partnere, por tashmë opozitare. Deputeti nuk zbulon emrin, por janë pikërisht komentuesit, ata të cilët kanë shkruar emrin e Ylli Manjanit, i cili ka mbajtur postin e zv.ministrit të Transporteve e më pas në koalicion me PS mori postin e ministrit të Drejtësisë. "Historia nr. 1: ...Në Lezhë, tek një restorant të 'Rana e Hedhun' tregojnë... Na ishte njëherë një zv.ministër i qeverisë 'Rama', por i një force partnere, tashmë opozitare e papare! Ishte ulur në një restorant për të dreku me familjen dhe i vjen kamerieri me marrë pagesën. Këtij... iu duk habi e madhe! Kërkoj pronarin e lokalit. Pronari nuk vajti. Ky ngulte këmbë që të vinte. Kamerieri kërkonte pagesën, ndërsa ky Zv-ja vazhonte të kërkonte pronarin. Pas një sere sorollatjesh të kamerierit nga klienti zv.ministër te pronari i lokalit, ky i fundit i thotë kamerierit që i thuaj se i ke të paguara nga lokali. Pas kësaj, Zv-ja u qetësua dhe iku i relaksuar me dreken e paguar 'forcërisht!' Ky tani ka kap penën e jep mend poshtë e përpjetë, për politike e për ç' t'i vijë në mendje. Më vonë vijojmë me të tjera, më skandaloze se kaq!", shkruan deputeti i PS, Ndreu.



# BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht!

### Dash Shehi rrëfen kush është femra më e bukur në parlament

Deputeti Dashamir Shehi, një nga emrat që gëzon më shumë mbështetje nga figurat e opozitës, vendosi dje të rrëfehej në një histori në "InTV". Sa i takon politikës, ai e shikon aktualitetin një moment dekadence të qeverisë dhe e konsideron atë butaforike e TV, shqetësuar për sheshe fasadë, duke lënë pas dore investimet e tjera infrastrukturore e strategjike. Në një krahxim mes Ramës e Berishës në kontekst shumëplanësh, Shehi tha se edhe në raport me Francën, Berisha ishte më dinjitoz se shkoi atje si doktor. Më tej, Shehi u pyet për femrën më seksi shqiptare dhe ai përmendi faktin se në parlament ka gjithmonë e më shumë femra të bukura, por për sharm do të veçonte Arta Daden.



### Reagimi i Melania Trump kur i dha dorën Putinit po bën xhiron e Botës

Reagimi i zonjës së Parë e SHBA-ve, Melania Trump pas takimit me Presidentin rus, Vladimir Putin, po bën xhiron e botës në internet. "Daily Mail" i ka kushtuar rëndësi momentit kur Melania shtërngon duart me liderin rus dhe më pas ngelet e shtangur. Fillimisht ajo i buzëqesh Putinit kur i jep dorën, por më pas i ngrin buzëqeshja. Ajo shihet teksa hap sytë dhe drejtohet nga kamerat.



## REAGIMI

# Vrocllavi, organizator i "botërorit" të teatrit dhe alibia e rreme e Lalit për "UEFA-n e teatrit"

Nga Kastriot Çipi\*

Dëgjesa e dytë (dhe e fundit) që z. Veliaj bëri sikur bëri me artistët e teatrit, rezervoi edhe spekulimin më të paturpshëm, që është dëgjuar ndonjëherë, në fushatën gëbelsiane kundër teatrit (TK e TKE). Duke hequr një paralele të pamundur mes stadiumit dhe teatrit, z. Veliaj shtroi pyetjen: Po të kishte një "UEFA" (Federata Europiane e Futbollit) për teatrin, siç ka për futbollin, a do ta certifikonte ajo Teatrin Kombëtar? Dhe përgjigjen e dha po vetë: Jo. Ky teatër nuk i plotëson kushtet (të cilat ende nuk janë bërë të ditura!), kështu që duhet të shembet.

Në fakt, për teatrin ka një "FIFA" (Federata Botërore e Futbollit) dhe ajo organizon një "Kupë Bote" që quhet "Olimpiada e Teatrit". Veprimtaria ka filluar të organizohet në vitin 1995 në Delfi, Greqi. Kjo "FIFA" e teatrit është Komiteti Ndërkombëtar i Olimpiadës së Teatrit, i përbërë nga 15 personalitete botërore, me në krye regjisorin grek Theodoros (Teo) Terzopoulos. (Nëse nuk më beson mua, z. Veliaj mund të pyesë Laert Vasiliu.) Edicioni i ardhshëm do të zhvillohet vjeshtë e ardhshme në Nju Delhi të Indisë.

Edicioni i fundit, i 7-ti, i Olimpiadës së Teatrit është zhvilluar në Vrocllav, Poloni, në vitin 2016, nën moton "Olimpiada e Teatrit në Kryeqytetin Europian të Kulturës". Në 2016-n Vrocllavi ishte "Kryeqytet Europian i Kulturës", një status që fitohet me vendim të Komisionit Europian dhe që sjell përfitime të mëdha ekonomike, sociale e kulturore për atë qytet. Është e kuptueshme se edhe fitimi i statusit bëhet përmes një konkurrence të fortë, të qyteteve dhe qeverive, që i mbështesin. Thënë ndryshe, që ky qytet me 630 mijë banorë të fitonte statusin e "Kryeqytetit Europian të Kulturës" për vitin 2016, qeveria polake, ajo e Distriktit të Silezisë së Poshtme dhe Bashkia e Vrocllavit kanë djersirë shumë. Sidoqoftë, ajo që na intereson në këtë shkrim është Olimpiada e Teatrit.

Faqja e internetit dedikuar këtij eventi madhor është ende aktive në adresën <http://www.wroclaw2016.pl/theatre-olympics-wroclaw-2016>. Aty mund të shihet i gjithë kalendari i ngjeshur me 700 shfaqje në 30 ditë. Në një listë të veçantë gjenden edhe të gjitha vendet ku janë zhvilluar veprimtaritë. Kjo listë përmban 40 objekte, ndër të cilat nja dhjetë janë teatro. Kjo është çudia e parë: qyteti me popullsi më të vogël se Tirana jonë ka dyfishin e teatrove. Por çudia më e madhe është se cilat janë këto salla, çfarë historie kanë dhe çfarë standardesh kanë. Nëse merrni mundimin të vizitoni këtë faqe, do të kuptoni se ndryshe nga futbollit, ku stadiumi du-

het të ketë patjetër një fushë me përmasa 105 x 68 metra, ndërsa kapaciteti duhet të jetë jo më pak se 60 mijë vende për veprimtari të rëndësishme europiane, teatri luhet edhe në skena të mëdha, edhe në skena të vogla; të tipit italian (si ato që tipikisht kanë teatrot tona) apo arena (ku publiku ulët në tria anët e skenës katrore), në salla me 70, 700 apo 1700 vende. Nuk është "UEFA e teatrit", por regjisorit, ai që vendos se cila sallë dhe cila skenë i përshtatet më shumë veprës së tij. Pra, për të organizuar një "Botëror" apo "Europian" teatri, detyrimisht duhet të kesh salla dhe skena të llojeve dhe madhësive të ndryshme. Po si ndodhi që ky qytet i ish-Europës Lindore, më i vogël se Tirana, u bë vendi organizator i "Botërorit" të Teatrit?

Vrocllavi (polonisht Wrocław, gjermanisht Breslau) ishte territor gjerman deri në mbarimin e Luftës II Botërore, kur iu bashkua Polonisë. Qyteti ishte i rrënuar nga bombardimet. 90% e 410 mijë banorëve të atëhershëm e kishin braktisur. Nëse polakët do të kishin pasur mendësinë e "rilindasve" tanë, ata do të kishin filluar ndërtimin e një historie të re të qytetit, përmes arkitekturës. Në mos të shembnin ndërtesat më ikonike të ndërtuara nga "armiqtë", së paku ata nuk do t'i rindërtonin ato. Justifikimin e kishin shumë të fortë: ndërtesat i kishte shkatërruar lufta dhe luftën e kishin filluar ata, pushuesit nazistë, që kishin rrënuar të gjithë Poloninë dhe Europën.



Kastriot Çipi

Por polakët zgjidhën të rindërtonin gjithçka, me të njëjten teknikë, duke u vënë ndërtesave madje edhe plaka me datën e ndërtimit dhe emrat e arkitektëve gjermanë, që i kishin projektuar!

Në vitin 1945, shtatë nga tetë teatrot e qytetit ishin gjermadha. I vetmi teatër që kishte shpëtuar mrekullisht ishte Opera. Për katër vjet me radhë, ky teatër i riemëruar përkohësisht Teatri i Madh, ishte streha jo vetëm e Operës, por

edhe e Teatrit të Kukullave dhe teatrit dramatik kryesor të qytetit, Teatri Polak, të gjithë të themeluar më 1945. Ndërkohë që Teatri Polak vazhdonte shfaqjet në sallën e Operës, rindërtohej teatri që do të bëhej selia e tij kryesore. Ky teatër ishte ndërtuar në vitin 1906 dhe kishte shërbyer si teatër muzikor (konzerthalle) deri më 1934 dhe teatër dramatik (schauspielhaus) më pas. Rindërtimi përfundoi më 1949. Pasi ndryshoi

emërtesë gjashtë herë, teatri i rindërtuar u quajt Teatri Polak - Salla në rrugën Zapolska (ish-rruga e Teatrit, theaterstrasse).

Megjithëse kishte sallën më të madhe (1736 vende) dhe më moderne në Poloni, Teatri Polak, si çdo teatër repertori në botë, i duhej edhe një sallë më e vogël. Herë pas here këtë funksion e kryente ajo që sot quhet Teatri Polak - Salla e Vogël (Teatr Polski - Scena Kameralna). E ndërtuar më 1909 si ki-

Francesca Anzani Ciliberti\*

Artistët e rinj kazertanë të "Compagnia della Città & Fabbrica Wojtyła", tashmë të paraqitur me shumë sukses në 2016 me veprën "Prova aktori" në Teatrin Kombëtar Eksperimental, "vëllai i vogël" i Teatrit Kombëtar të kryeqytetit shqiptar, janë të parët artistë ndërkombëtarë që vijnë në mbështetje të nismës intelektuale në mbrojtje të historisë kulturore të Shqipërisë.

Teatri Kombëtar, i vendosur në një ndërtesë historike të ndërtuar nga italianët në vitet '30, dëshmitar në dekadat e fundit i rilindjes kulturore të kombit, për një kohë të gjatë i shpatur nga diktatura, rrezikon të shembet për t'i hapur vendin projektit të një poli multifunksional me hotele, qendra tregtare dhe shërbime prej mbi 9 mijë metrash katrorë, duke përfshirë "edhe" një teatër të ri, ndërtimi i të cilit ka tërhequr vëmendjen negative të shtypit dhe institucioneve, kombëtare

e ndërkombëtare.

Artistët italianë të "Compagnia della Città & Fabbrica Wojtyła" janë bashkuar kështu me ata shqiptarë për një refleksim mbi rrezikun e zhdukjes së historisë dhe kujtesës, në një kryeqytet që ka prirjen të mos ruajë më asnjë dëshmi të rrugëtimit të tij kulturor. Thirrjes së zarrtë të atyre që përpiqen të bindin Presidentin e

Republikës, Ilir Meta, që ka vetëm një javë kohë për hedhur poshtë ligjin, artistët e "Fabbrica Wojtyła" i përgjigjen me një ndërhyrje me tinguj e fjalë më 24 korrik, para Teatrit Kombëtar në Tiranë, të nxjerra nga "Monodialogjet" e autorit dhe regjisorit italo-shqiptar, Patrizio Ranieri Ciu, që historikisht ka dhënë ndihmesë për procesin e rilindjes së identitetit

intelektual shqiptar.

Po aq aktorë vendës, njëkohësisht, do të përsërisin performancat e përkthyer në gjuhën shqipe, për një bashkim artistik e intelektual, që është vetë arsyeja e teatrit. Veçanërisht me interes do të jetë prania e një maske historike, një pjese moderne dhe një pjese muzikore, për të përfaqësuar universalitetin e përvojës teatrorë dhe të drejtën për të ruajtur historinë. Kështu, simbolet e Napolit, rajonit të Kampanias dhe Italisë zbarkojnë në Tiranë me Pulcinella-n, si përfaqësuese të Commedia dell'Arte, fillesa e teatrit, aktori i zi, si zëdhënës i avangardave të reja dhe zëri i Jugut, me këngët tradicionale dhe pjesët moderne të papublikuara, të gjithë gati për të shprehur një sekuençë kujtese të artit në kohë, një shkrirje mes së shkuarës dhe të tashmës, si metaforë e Teatrit Kombëtar, që është dhe duhet të jetë gjithmonë zemra e muzikës, dansit dhe teatrit shqiptar.



**"FIFA"**

Në fakt, për teatrin ka një "FIFA" (Federata Botërore e Futbollit) dhe ajo organizon një "Kupë Bote" që quhet "Olimpiada e Teatrit". Kjo "FIFA" e teatrit është Komiteti Ndërkombëtar i Olimpiadës së Teatrit, i përbërë nga 15 personalitete botërore

nema (Cinema Kammer-Lichtspiele), ajo u riemërtua Teatri i Kohës, ose i Orës (Theater der Zeit), pasi gjatë luftës u shfaqeshin çdo orë vetëm filma kronikalë, të propagandës naziste. Më 1945 kinemaja ishte rrafshuar tërësisht. Ajo u rindërtua nga e para dhe më 1949 aty u vendos Shoqata Hebraike e Vrocllavit, ndërsa me mbylljen e shoqatës, në vitin 1968, ky teatër u kthye në qendër komunitare. Pikërisht këtë sallë, me vetëm 262 vende (foto 4), të vendosur në oborrin e brendshëm të një blloku banimi, ku shkohet përmes një tuneli (foto 2), që nuk ka as pamje, as ndonjë stil për t'u vlerësuar (foto 3), e kërkoi vazhdimisht dhe më në fund e mori nën administrim Teatri Polak, në vitin 1990!

Jo vetëm kaq, por në vitin 1994, Teatri Polak fitoi edhe sallën e tretë. Në janar 1994 salla e madhe u dogj aksidentalisht. Drejtuesit e Teatrit Polak kishin frikë se mos qeveria, me këtë pretekst shkurtonte fondet dhe pakësonte numrin e artistëve dhe personelit teknik të teatrit. Me urgjencë të madhe, ata zgjodhën një hapësirë, i kërkuan një arkitekti projektin dhe i paraqitën qeverisë një propozim, që rezultoi i suksesshëm: ndërtimin e një teatri në një pjesë të ish-stacionit hekurudhor Shvieboxki (Swiebozki). Ky stacion, i ndërtuar më 1843, ishte mbyllur përfundimisht më 1990. Pikërisht këtu, në pjesën që funksiononte si mobilieri, u ndërtua ai që sot quhet Teatri Polak - Salla Shvieboxki (fotot 5 e 6).

Por cudia më e madhe për ata që besojnë propagandën e Gëbel-sit të "rindildjes" është Teatri Arka (foto 7). Edhe kjo ndërtesë njëkatëshe, pa kullë skene, pa auditor, thjesht një ish-magazinë e struktur në oborrin e vogël të Teatrit Polak - Salla e Vogël, ku shkohet përmes të njëjtit tunel, ishte një nga sallat e zgjedhura për Olimpiadën e Teatrit, pra të certifikuara nga "FIFA" e teatrit.

Mund të kisha vazhduar me të gjitha sallat e tjera të teatrove të Vrocllavit, shumica të ndërtuara nga gjermanët para luftës, një pjesë jo si teatër, madje as si kinema, të gjitha të shkatërruara nga bombat e të gjitha të rindërtuara pas lufte, një pjesë edhe të zgjeruara e modernizuara pas vitit 1990. Por besoj se me kaq është e qartë për atë publik që do të arsyetohet se teatrot nuk shemben sepse i ka ndërtuar pushtuesi, madje as për t'u zëvendësuar me teatro të tjerë, më modernë. Ato thjesht restaurohen herë pas here dhe mbijetojnë, të lumtur në shoqërinë e teatrove të rinj.

**\*Regjisor, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit**

**FESTIVALI**



# Zani i humbur në Theth

Fatmira Nikolli

**Ë**shtë ora 16:00 kur kisha ikonë hap dyert për të mbajtur meshën e shenjtë. Përveç ajrit dhe kishës që shënjtojnë perceptimin tonë mbi Thethin e hijshëm, gjithçka tjetër lë për të dëshiruar, njësoj si shekullin e kaluar, kur andej pari kalonin udhëtarë e antropologë për ta bërë fshatin mes maleve parajsën e tyre të zgjedhur përmes shkrimeve të pavdekshme. Ngjan se koha ka ndalur kur heq sytë nga shënimet e tyre për të parë se 10 dekadat pothuaj nuk kanë lënë gjurmë. Shtigjet e kahershme ia kanë lënë radhën një "udhe qerresh" të pashtuar, për hapjen e së cilës vetëm sa është kafshuar mali, ndaj rrugëtimi premtom të jetë "aventurë" më vete.

**UDHË E GJATË**

Është mëngjesi kur makina 4x4 merr teposhtën mes malit nga Qafë-Thorja drejt Thethit pa t'i kursyer tronditjet, ndonëse ecën me 10 km në orë. Vetëm një i çmendur do e merrte atë udhë me makinë qyteti. Në rreket për të shkuar mes alpeve, shpesh duhet të kthehesh mbrapsht për metra të tëra mbi shkëmbinj që janë bërë shtrati i rrugës që të ndërrosh me një makinë tjetër. Nuk ka tabella, asnjë sinjalistikë rrugore, asnjë shënim. Veç portreti i Durhamit qëndron në një kthesë shtati të zhveshur. Poshtë sheh si greminë, edhe pemishtet e larta drejt qiellit, që veç ajrit të pastër, të mbrojnë nga rendja në honet e frikshme. Kilometrat nuk janë shumë, por rruga shkon gjatë. Vit pas viti, në fushata elektorale është premtuar vëmendje për zonën e izoluar. Por në fund të sezonit elektoral dhe atij veror, të gjithë ikin nga Thethi. Atëherë fshati ndryhet në harrësë, si në legjenda, mes mjegullës e premtimeve të pambajtura. Duket aq lehtë t'ia kthesh shpinën e ta lësh të fshehur deri në sezonet e ardhshme. Zani atje humb dhe

nuk dëgjohej në bulevardet qytetëse ku aparatet shkrepin 'sukseset e rastit', duke e mbytur piskamën e të mbeturve në izolim. Mjerisht, edhe fonte të mëdha që do ta kishin ndihmuar fshatin që t'i përngajë në shërbime Tirolit a Zvicrës, janë dëgjur me ndihmën e shtetit shqiptar (ose prej mospërgjegjësive të tij). Dora e shtetit nuk shihet, ndonëse kartolinat janë shpërndarë nëpër profile institucionesh me kënaqësinë e 'zbulimit' të një Amerike të re.

**ZANI I HUMBUR**

Pamja e fshatit nga rruga të bën të mbash frymën. Uniteti i ndërtimeve karakteristike të zonës ruhet paçka ndonjë gabimi të kapur në kohë. Oborri i kishës është zënë; përpara nga një panair modest ku evidentohen më shumë çadrat se produktet, e pas, nga pajisjet e 'ZaFest' që i janë ngjitur deri edhe murit të saj. Dom Artur Jaku i ardhur nga Shkodra për t'iu drejtuar besimtarëve e nis meshën në ertë-sirë, duke lexuar fjalën e Jeremisë profet, që iu drejtohet udhëheqësve të korruptuar të Izraelit me fjalët "vaj për barinjët që e lënë të sharrojë dhe e shpërndajnë grigjën time

thotë Zoti".

Në radhë të dytë në kishë qëndron kryetarja e Bashkisë Shkodër, Voltana Ademi. Meshtari bën paralelizma mes kohëve të Izraelit e kohëve të Thethit në predikimin e vet dhe kambanat mbase nuk ranë në vesh të shurdhër. Ka kaluar gjysma e meshës kur një burrë me pantallona të shkurtra kalon (krejt pa takt) pas meshtarit dhe merr e jep me siguresat. Dritat erdhën bashkë me hyrjen në kishë të ambasadores së BE-së, Romana Vlahutin që ka ardhur për të ndjekur festivalin e financuar nga tri institucione shtetërore e disa organizata të huara, mes të cilave edhe nga BE. Ajo ulet në fund dhe merr kungimin si besimtarët e tjerë.

Ka një farë pezmi pas fjalës së meshtarit që lë të kuptohet se Thethi i sotëm me atë të dëshmuar nga Edit Durhami a George Heinsheimer pakogjë ndryshon.

Mesha mbaron dhe shumë drejtues mund të gjejnë shigjetat ndaj tyre në predikimin e mbajtur. Nëse duan ta lexojnë drejt. Mesazhet që jepen në këtë kishë janë pothuaj si 100 vite më parë: ka ende nevojë

për të njëjtat gjëra, nisur nga vëmendja e qeverisë. Kisha, që një shekull më parë jepte mësimë të shqipes sepse shërbente edhe si shkollë, tanimë i dha 'mësimet' në shqip. "Frati i kish mprehur mirë penën", thonë banorët në fund të meshës. Pas meshës, Zafesti mbledh në oborrin e pasmë të kishës një grup spektatorësh, që në numër janë po aq sa marrin pjesë në protestën e përnatshme të teatro kombëtarë. Festivali ka mbështetur e gjithë shtetit, teatri ka kundër gjithë shtetin, por përkrahësit e i kanë njësoj.

Vitet e fundit kemi parë mjaftueshëm festivale e evente me financime publike që shkojnë për një grusht ftohs; jo për eventet në vetvete se sa për imazhet që duhet të shpërndahen në rrjet. Një menaxhim më i mirë i këtyre financimeve do të kishte mundur 'ta mbulonte shtëpinë para se ta lyente, sepse nusja e re a dasmorët do të duan strehë më shumë se sponde'.

Kur festivali u mbyll, ai lumi i fotove që do të duhej të përcillte suksesin e artistëve që në fund të ditës bënë atë që dinë të bëjnë, pra art, u baltos nga një lum ftohs që tregonte pirgje plehrash në anë të kishës. Mes thirrje të turmës në rrjet që nisnin me fjalën "turp", dikush do e ketë dëguar se Vlashent Sata u bëri thirrje të pranishmëve të mos hidhnin plehra në tokë. "Ideja për këtë festival lindi kur ne donim të pastronim Thethin, ndaj ju lutem mos hidhni plehra". Me dorë bëri nga dy a tri qese të zeza të varura në mbajtëset e ndriçuesve. Duket ato pak qese nuk kanë mjaftuar, sikundër nuk mjafton të ftohs turistë të bëjnë kamping ku nuk të sheh syri facilitet minimalë që nuk kanë nevojë për investime madhore. Shpesh mjaftojnë idetë dhe punët e vogla: si koshat për plehra, tualete publike në paqe me natyrën, ndonjë tabelë dhe mos me ba pis kur nuk pastron dot. Edhe këtë herë, zani humbi në Theth.

Meshtari bën paralelizma mes kohëve të Izraelit e kohëve të Thethit në predikimin e vet dhe kambanat mbase nuk ranë në vesh të shurdhër. Ka kaluar gjysma e meshës kur një burrë me pantallona të shkurtra kalon (krejt pa takt) pas meshtarit dhe merr e jep me siguresat. Dritat erdhën bashkë me hyrjen në kishë të ambasadores së BE-së, Romana Vlahutin

Opinion i Ditës

# Diplomacia parlamentare, jetike për negociatat

Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... i Kryetarit të Kuvendit, zotit Gramoz Ruçi me përfaqësues të medias dhe shtypit. Kjo kryesisht për theksimin e veçantë parlamentar mbi këtë moment madhor politik, larg zhurmës dhe bujës, si gjithnjë “me këmbë në tokë”, në vend të etiketimeve bajate për “sukses” apo “dështim” aty u pohan sfidat reale deri në çeljen e negociatave, duke nënvizuar angazhimin e veçantë të Kuvendit edhe me “diplomaci parlamentare”.

Ky angazhim cilësisht i ri i Kuvendit diktohet nga fakti se përpara ndezjes së dritës jeshile për çeljen e negociatave do të kërkohet miratimi dhe nga parlamentet e vendeve anëtare e jo si deri më tani vetëm nga 2 - 3 të tilla.

Veç “gjynaheve” tona kjo procedurë që zbatohet për herë të parë për çeljen e negociatave është pasojë dhe e “luftës së bërrylave” për më shumë pushtet ndërmjet vendeve anëtare dhe Komisionit/Parlamentit Evropian ose ndërmjet përfaqësues “ndëqeveritare/kombëtare dhe asaj supranacionale.

Kjo prioritet po forcohet me përkallëzimin e forcave populiste dhe ekstremiste dhe si sanksion ndaj “tiranisë dhe burokracisë së Bruselit” të përfaqësuar sipas tyre nga Komisioni dhe deri diku dhe Parlamenti Evropian.

Franca, Holanda, Danimarka, në një masë më vogël Gjermania e më vonë ndoshta dhe ndonjë vend tjetër janë mbështetës kryesorë të kësaj rryme.

Për pasojë, fuqinë reale në procesin e zgjerimit më shumë se qeveritë dhe ministrat e jashtme do ta kenë parlamentet e tyre, si përfaqësuese të zgjedhura e që duan të jenë aktive dhe për aspekte të tilla të nxehta dhe shumëpalëshe, si azili, emigracioni, korrupsioni, droga dhe krimi i organizuar, të cilat i referohen gjerësisht edhe Ballkanit Perëndimor.

Kësisoj, krahas vazhdimit të punës intensive me Komisionin, Parlamentin Evropian, qeveritë dhe diplomacitë e vendeve anëtare do të na duhet dhe më shumë “to make the case” pra t’u mbushim mendjen me rezultate konkrete edhe parlamenteve të tyre. Mirëpo, këto të fundit dhe deputetët e tyre nuk impresionohen nga tabelat statistikore dhe shifrat krahasuese me të kaluarën, por nga perceptimi publik për problemet në fushat e lartpërmendura përkundrejt standardeve dhe pritshmërive përkatëse.

Gjithashtu, me parlamentet dhe deputetët kërkohet punë e vazhdueshme “kokë më kokë” dhe në shumë fronte, proces ky i mundimshëm e që kërkon kohë, me plot të



papritura dhe të panjohura. Rasti i polemikave apo dhe i ndonjë incidenti me deputetë të veçantë në ndonjë prej vendeve të lartpërmendura dëshmojnë qartë për këto vështirësi.

Kjo ndodh dhe sepse deputetët e huaj, në opozitë dhe mazhorancë nuk i binden kurrukujt lehtë, ca më pak apriori dhe pa argumente bindëse; zëri i tyre dëgohet me vëmendje dhe merret parasysh gjatë vendimmarrjes edhe kur janë në pakicë; sepse krahas votës dhe numrave kanë rëndësi parësore mesazhet dhe alternativat, sepse nesër të gjithë do të ballafaqohen me elektoratin dhe pakica mund të kthehet në shumicë.

Ndaj, ky hendek dhe këto sfida nuk mund të përballohen pa përfshirjen efikase të Kuvendit tonë, sado mirë të ecë puna me institucionet e tjera.

Lajmi i mirë këtu është se strukturat, formatet dhe mundësitë dy dhe shumëpalëshe të Kuvendit tonë janë të mëdha dhe të larmishme; çështja është si ato të aktivizohen në mënyrë optimale, pa rënë në dublime dhe pa i kthyer deputetët tanë në zëdhënës të qeverisë çka do ta komprometon të procesin.

Në respekt të përpjekjeve në proces nga Kuvendi dhe në këtë fushë dhe mbështetur në përvojën e gjatë në shërbimin e jashtëm, ku dimensionin parlamentar ka qenë përherë i pranishëm, më poshtë po japim disa sugjerime praktike.

Së pari, ky proces fillon me komunikimin me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së me një letër të Kryetarit të Kuvendit për homologët e tij, me dëshirën për vendosjen e një bashkëpunimi të vazhdueshëm mes strukturave përkatëse.

Në vijim, këtij qëllimi do t’i shër-

bejnë takimet e vazhdueshme ndërmjet kryesive, grupeve parlamentare, të Komisionit të Jashtëm e të Integritimit, të drejtësisë dhe punëve të brendshme, etj. me homologët e tyre të huaj, sidomos me parlamentet e vendeve skeptike; kësaj, do të ndërthuren axhendat përkatëse dypalëshe me secilin parlament të vendeve anëtare të BE-së.

Rol të veçantë e të spikatur kanë Grupet Parlamentare të Miqësisë me vendet e ndryshme. Tani është momenti që këto grupe dypalëshe dhe sidomos drejtuesit e tyre të vihen më mirë në lëvizje, si aktorë kryesorë dhe me besueshmëri më të madhe. Avantazhi i tyre është se aty ka deputetë dashamirës dhe me ndikim të madh në krijimin e opinionit pozitiv. Kështu, ministri i Brendshëm Federal belg Jan Jambon ishte deri vonë anëtar i këtij grupi bashkë me deputetët të tjerë të Partisë nacionaliste N-VA në pushtet. Falë edhe marrëdhënieve miqësore të krijuara nga Kuvendi dhe ambasada jonë në Bruksel në vazhdimësi e jo vetëm kur “ishim në hall” edhe me deputetë të N-VA-së, ajo e ka mbështetur gjithnjë integritimin tonë në BE.

Ky dhe shembuj të tjerë që tregojnë rëndësinë e madhe të krijimit me kohë edhe të marrëdhënieve miqësore informale dhe personale me deputetët e huaj, larg paragjyqimeve partiake dhe polemikave të panevojshme e pa “be-reqet”; shpesh kjo bëhet vendimtare në përshpejtimin e mirëkuptimit dhe besimit reciprok parlamentar.

Forma të tjera të dobishme që ndihmojnë për ta mbajtur gjallë këtë frymë të përhershme komunikimi janë forumet ndërkombëtare e rajonale parlamentare,

takimet e kryetarëve dhe drejtuesve të tjerë të lartë të Kuvendit me homologë të tyre, prania krahas formave të tjera të bashkëpunimit me to e deputetëve në përbërjen e delegacioneve të kryesuar nga Presidenti, Kryeministri dhe ministri i Jashtëm, etj. Por kjo jo për “dekor” por si pjesë jetike e tyre. Për këtë qëllim, në vend të protagonizmit të tepruar politik kërkohet me shumë iniciativë, fantazi dhe krijimtari.

Avantazhi tjetër i Kuvendit është se aty e rreth tij ka ish-ministra të Jashtëm e të Integritimit Evropian, ish-ambasadorë dhe ekspertë të politikës së jashtme, sigurisë dhe diplomacisë, fjala dhe imazhi e të cilëve zë vend kudo.

Informimi i ndërsjellët përbën frontin tjetër tejet të rëndësishëm për të mbajtur në korrent parlamentet e huaja për zhvillimet në vendin tonë. Por, kujdes, në këto njoftime të mbizotërojnë krahas arrijeve pozitive edhe puna që bëhet për kapërcimin e mangësive, pengesave dhe vështirësive të ndryshme e jo vetëm për “bëmat”.

Gjithsesi, veprimtaria e këtyre strukturave dhe formateve është vetëm gjysma e punës. Për të patur efektivitetin e duhur, kërkohet detyrimisht bashkëpunimi i efektive dhe jo vetëm me fjalë e deklarata mediatike i partive politike parlamentare. Natyrisht secila prej tyre ka dhe shpreh interesat dhe këndvështrimet e saj dhe në vizita, takime dhe forumet e lartpërmendura; por, nëse duam që negociatat të çelen sa më shpejt, pa mohuar dhe anashkaluar vërejtjet dhe alternativat e opozitës, kjo e fundit duhet të tregohet më e kujdesshme politikisht duke filluar nga gjuha dhe zharëni i saj politik. Pa hequr dorë nga oponenca konstruktive fry-

ma e veprimit të saj duhet të jetë nxitja e vendeve të tjera dhe ndikimi për një perceptim sa më pozitiv te partnerët tanë për këto negociata.

Por dhe shumica parlamentare ka vend të jetë më e përm-bajtur, të respektojë idetë dhe mendimet e opozitës, të shmangë karshillëkun dhe qëndrimet “majë më majë”. Ndryshe, “në vend që t’i vëmë vetullat, do t’i nxjerrim sytë” këtij procesi. Le ta themi troç se në mungesë të dialogut politik me opozitën, çdo lobim apo demarsh tjetër do të jetë i pavlefshëm. Shembull pozitiv në këtë fushë është Kroacia, ku gjatë dy dekadave të kaluara, anëtarësimi në BE dhe NATO u bë ura madhore bashkuese e forcave politike.

Së fundi, avantazhi tjetër krahasues i Kuvendit është se për shkaqe të ndryshme, drejtuesit e tij më të lartë nuk janë të ekspozuar dhe të ezauaruar me fjalime, intervista, polemika dhe takime brenda e sidomos jashtë vendit, veçanërisht në fushën e integritimit. Pavarësisht nga debatet dhe incidentet parlamentare, veç ish - Kryetarit të saj, tashmë President i Republikës, Kryesia e Kuvendit mbetet pika kryesore e referimit dhe bashkëpunimit ndërpartiak, brenda dhe jashtë vendit.

Le ta ilustrojmë këtë me dy shembuj. Në muajin mars isha i pranishëm në një takim pune rajonal me ftesë të Parlamentit Evropian me një grup me deputetë të zgjedhur për herë të parë nga të gjitha forcat tonë politike. Imazhi që ata krijuan me përgatitjen, diskutimet dhe qëndrimin e tyre politik ishte tejet pozitiv për mikpritësit e tyre dhe të tjerët.

Shembulli tjetër i këtyre ditëve të fundit është nisja domethënëse e vlerësuar e zotit Gramoz Ruçi për vendosjen e bustit të opozitarit brilant, Kryetarit legjendar të Kuvendit, zotit Pjetër Arbnor; një akt i mirëpritur simbolik dhe jashtë vendit, shembull i spikatur i emancipimit politik, parlamentar dhe qytetar që besojmë të mos jetë i fundit.

Ja përse zëri, mendimi dhe veprimi i diplomacisë parlamentare të Kuvendit, në drejtim dhe bashkëpunim të ngushtë me aktorët dhe faktorët e tjerë të lartpërmendur me siguri do të jetë më i freskët, më i besueshëm dhe për rrjedhojë më efikas.

Natyrisht, sukcesi i saj kërkohet si kusht paraprak ecurinë e reformave brenda vendit, ku sërish Kuvendi ka rolin e tij të pazëvendësueshëm dhe të procesit përgatitor për çeljen e negociatave me Komisionin Evropian nga ana e qeverisë/diplomacisë, pa e fetishizuar këtë akt dhe jo si “skillevër” datash.

Opinioni *i* Ditës

# Mësytymja fiskale në bregdet


Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... se dy muaj (1 korrik-25 gusht) realizon një xhiro prej 800 milionë eurosh në bregdetin tonë. Dhe rreth 85 përqind të tij, në zonën Durrës-Shkëmbi i Kavajës dhe Vlorë-Sarandë. Kryesisht, kontrollet masive u realizuan në Sarandë, Ksamil, Himarë dhe Dhërmi, ku u bllokuan 11 hotele, të cilat figuronin të paregjistruara në organet tatimore, si dhe u gjobitën rreth 45 përqind e bizneseve të kontrolluara.

Nga njëra anë, mirë bënë që kontrolluan. Mirë se erdhën në një territor pak të parë nga syri i shtetit tonë në gjithë periudhën 1990-2017! U qoftë falë djersa e derdhur nëpër kontrolle në këtë vapë përvëluese! Por një pyetje lind natyrshëm: ku ishin deri tani kjo farë sokolash? Çfarë bënë kur në bregdet bëhej kërdia në vitet 2016 dhe 2017, me çmimet në qiell dhe trajtim të diferencuar mashtrues për shumë turistë të huaj, që nga çmimi dyfish i shezlongëve i dhënë kundrejt një letre bakalli si faturë e deri tek një birrë korona dhjetë mijë lekë të vjetra? Apo vjet ishte vit zgjedhor? Megjithatë, më mirë vonë se kurrë, thotë populli.

Por, edhe pse zaret u hodhën në 25 qershor 2017 dhe i kishin të gjitha mundësitë të ndalonin abuzimin në bregdet edhe në fillim të korrikut të vitit të kaluar, nën dehen e fitores, nuk e bënë. Nuk e kryen as edhe në muajt mars-maj 2018, kur bëhen përgatitjet për sezonin veror turistik. Dhe kur dhëmb më pak, ose demë në imazh i vetë kësaj industrie kaq delikate nuk është kaq i madh. Kur, në rast se dëshiron të mos i prishësh sezonin sipërmarrjeve me më të ardhme në ekonominë tonë, ato turistike, ashtu edhe gjysmë formale e me probleme të mbartura kapicë sikurse janë, jo vetëm për faj të tyre, mund të nisësh kontrolle paraprake dhe parandaluese. Sikurse u bë gjatë gjithë gushtit 2015, me aksionin anti-informalitet. Por jo, u vendos pikërisht në pik të sezonit, pikërisht atëherë kur dhëmb më shumë, kur edhe ndërhyrja merr formë të shëmtuar, nga prania masive e turistëve të huaj e vendas nëpër plazhet tona.



Edhe njëherë, u bë mirë që u ndërhy më në fund! Mirëpo përgjegjësia e një indiference gati trevjeçare nuk mund të anashkalohet. Tani që goditja u dha, duhet të ndodhë transformimi. Duhet një trajtim sa më dobiprurës për sipërmarrjet e kapura në sh-

kelje të ligjit, dhe jo të shihen ato si armiket e popullit. Duhet që tani timori të mos peshkojë në ujë të turbullt dhe të "favorizojë" ato subjekte (kompani, motele, hotele, restorante, etj.) të gjobitura që i paguajnë nën dorë. Kanë ndodhur rëndom raste të tilla në të kalu-

arën dhe nuk është aspak keq t'i fryjmë kosit tani, që jemi djegur nga qulle pas qullesh. Dhe kryesorja, Ministria jonë e Financave dhe Ekonomisë duhet të dalë me një plan të qartë masash jo vetëm dënuese, por edhe këshillimesh dhe orientimesh për sipërmarrjet që jo qëllimisht janë kapur në shkelje të ligjit. Sigurisht që është shumë e vështirë të kuptosh kufirin gati të padukshëm të qëllimit nga mosqëllimi dhe pakujdesia jo fajtores në një shkelje fiskale. Por duhet bërë, se bëhet fjalë për sektorin më jetik të ekonomisë së vendit, të cilit i takon pajzgjdhshmërisht e ardhmja, në rast se nuk e keqtrajtojmë dhe e mbysim administrativisht ende pa u rritur plotësisht, sektorit të turizmit.

Nga njëra anë, mirë bënë që kontrolluan. Mirë se erdhën në një territor pak të parë nga syri i shtetit tonë në gjithë periudhën 1990-2017! U qoftë falë djersa e derdhur nëpër kontrolle në këtë vapë përvëluese! Por një pyetje lind natyrshëm: ku ishin deri tani kjo farë sokolash?

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Frika që do ndieni sot do t'ju demoralizojë. Mendoni pozitivisht dhe shihni anën e mirë të gjërave. Sharmi dhe personaliteti juaj do t'ju ndihmojnë të bëni miq të rinj. Sot do të jetë dita juaj me fat sa i përket romançave. Ka gjasa që të bëni disa plane në moment të fundit.

**DEMI**  
Sjellja juaj do të bëjë konfuzë njerëzit pranë jush. Vendimet e rëndësishme për investimet lëri për një ditë tjetër. Sa i përket marrëdhënies në çift nuk do të jetë dita e duhur. Do të fitoni shumë nëse jepni mendimin tuaj para personave të rëndësishëm.

**BINJAKET**  
Përpiquni të ruani qetësinë me njerëzit që ju rrethojnë. Ka gjasa që sot të keni rritje të të ardhurave. Do të kaloni një ditë shumë të bukur romantike dhe do të bëni plane shumë të veçanta me partnerin/partneren tuaj.

**GAFORJA**  
Bëni kujdes me shëndetin, sidomos personat që vuajnë nga tensioni. Sot do të shiheni të gjitha borxhet e mbeturra. Partneri do t'ju kërkohet më shumë përkushtim. Sa i përket punës, do të keni një bashkëpunim shumë të mirë me kolegët.

**LUANI**  
Përpiquni të relaksoheni. Dini shëtitje me partnerin dhe fëmijët tuaj. Bëni pak më shumë kujdes për shëndetin. Shefi juaj do të shprehë vlerësim për punën tuaj sot. Një pjesë të ditës do ta kaloni duke u argëtuar me miqtë.

**VIRGJERESHA**  
Një miku juaj do t'ju inkurajojë shumë për të ndjekur nga pas problemet me shëndetin. Bëni kujdes me financa, mos u nxiloni me veprimet tuaja. Anëtarët e familjes do të tregojnë shumë dashuri për ju sot. Sa i përket marrëdhënies në çift, do të ndihni shumë komodë dhe do të vlerësoni maksimalisht partnerin/partneren tuaj.

**PESHORJA**  
Mund të acaroheni nga sjellja e anëtarëve të familjes. Mos humbni durimin, përndryshe situata do t'ju dalë jashtë kontrollit. Mos bëni komente të nxitara dhe ruani qetësinë. Personat që kanë lidhje me artin, do të gjejnë disa mundësi të reja për të dhënë anën tuaj më të mirë kreative.

**AKREPI**  
Investimet që do të bëni sot do t'ju sigurojnë një të ardhme shumë të mirë. Lidhja juaj romantike do të bëjë hapa pas, sepse partneri/partnerja juaj do të tregohet shumë kërkues. Ju pret një ditë e mirë, pasi do të vlerësoheni shumë në punë.

**SHIGJETARI**  
Përpiquni të mos tregoheni të pasigurt. Sot do të keni një zhvillim shumë të rëndësishëm në jetën tuaj personale. Bëni kujdes me fjalët pasi mund të lëndoni njerëzit përreth jush. Është koha e duhur të ndërmerri disa projekte të reja.

**BRICJAPI**  
Përpiquni të mos konsumoni shumë alkoool. Paratë që ju teprjnë, kurseji dhe mos bëni shpenzime të kota. Kujdes në marrëdhënien në çift pasi do të jetë një ditë e tensionuar. Sa i përket marrëdhënieve shoqërore, do të kaloni një ditë shumë të mirë.

**UJORI**  
Do të jeni pjesë e një feste që do t'ju bëjë të ndiheni shumë mirë. Kurseni sa më shumë që t'i bëni ballë të ardhmes. Sot do të ndihni shumë të dashuruar, madje më shumë seç mund ta kishit imagjinuar. Puna nuk do t'ju eoh shumë dhe ka gjasa që të mërztiteni në këtë aspekt.

**PESHQIT**  
Problemi me ju është që nuk përpiqeni, por vetëm ëndërroni. Sot do të keni fitime të kënaqshme. Do të shqetësoheni për disa çështje që do t'ju shkaktojnë stres. Përpiquni t'i zgjidhni ato me ndihmën e familjarëve. Do të keni edhe disa zënka, të cilat do t'ua vështrësojnë edhe më shumë situatën.

## LETËR E HAPUR

# Letra e muxhahedines për Fatmir Xhafajn: Agjentët e Iranit janë në Shqipëri!

Nga Somayeh Mohammadi\*

Kohët e fundit vendet europiane janë marrë në shënjestër nga terroristët e regjimit iranian. Më 30 qershor një diplomat iranian u arrestua në Gjermani pasi i kishte dorëzuar eksplozivët dy terroristëve në Luksemburg. Në të njëjtën ditë, dy terroristët të regjimit iranian u arrestuan në Belgjikë dhe kolegu i tyre u arrestua në Francë.

Qëllimi i tyre ishte të bombardonin tubimin e përvitshëm të muxhahedineve iranianë, MEK, në Paris. Më pas departamenti amerikan i shtetit zbuloi se marsin e kaluar në Tiranë ishin arrestuar terroristët iranianë. "Kohët e fundit, iranianët banues në Tiranë kanë dhënë informacione për praninë e njërit prej agjentëve të Ministrisë së Inteligjencës së Iranit, me emrin Mostafa Mohammadi. Vajza e këtij personi, Somayeh Mohammadi, e cila është anëtare e MEK dhe banon në Shqipëri, ka zbuluar se Mostafa Mohammadi, i cili ka ardhur në Shqipëri me pretekstin për ta vizituar, është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit dhe ka patur rol kryesor në torturën psikologjike të banorëve të Ashraf në Irak, njofton MEK.

Znj. Mohammadi ka shkruar, gjithashtu, një libër rreth kësaj, të titulluar "Fundi i një komploti". Në këtë libër ajo shpjegon se si i ati, i cili është dërguar tani në Tiranë, ishte rekrutuar nga Ministria e Inteligjencës e Iranit dhe se si ai ishte bashkëpunëtor në vrasjet e anëtarëve të MEK në Irak. Znj. Somayeh, në një letër drejtuar ministrit të Brendshëm shqiptar, ka kërkuar përfshirjen e Mostafa Mohammadi-t nga Shqipëria. Ajo e ka ndarë letrën edhe me mediat. Teksti i plotë i letrës:

**LETRA E PLOTE**

I nderuari Fatmir Xhafaj, Ministër i Brendshëm i Shqipërisë

I nderuari Ministër,

Unë jam Somayeh Mohammadi, banuese në Shqipëri dhe anëtare femëre e Organizatës Muxhahedine të Popullit të Iranit (PMOI).



Kam mësuar se im atë, Mostafa Mohammadi, i cili është, gjithashtu, agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit (MOIS), ka ardhur në Shqipëri me pretekstin për t'u takuar me

mua, por në të vërtetë për të realizuar misionet kundër PMOI të caktuara nga regjimi iranian.

Në vitin 1998, në kërkim të lirisë dhe demokracisë për Iranin, unë e lashë me



vullnetin tim banesën time në Kanada dhe, si shumë iranianë të tjerë që e duan lirinë, u bëra pjesë e PMOI dhe shkova në Kampin Ashraf në Irak. Erdha në Shqipëri me miqtë e mi të tjerë pasi u larguam nga Iraku.

Kur ishim në Irak, regjimi iranian mundi të keqpërdorte disa anëtarë të familjeve tona, përfshirë tim atë, kundër PMOI duke i kërcënuar apo joshur ata. Pas takimeve të tij me mua në Kampin Ashraf në Irak në vitet 2002, 2003 dhe 2004 dhe pasi u kthye në Kanada, ai deklaroi papritmas para shtypit dhe autoriteteve kanadeze se PMOI kishte mbajtur me forcë në Kampin Ashraf kundër vullnetit tim. Ai krijoi blog-e propaganduese në emrin tim në internet, dhe, duke publikuar fotot e mia personale në këto blog-e, dhe duke aplikuar trysni të tjera, ai donte të më bënte të dorëzohesha dhe të bashkëpunoja me regjimin iranian.

Bashkëpunimi i tij me shërbimin e inteligjencës së regjimit iranian (MOIS) si dhe shpifjet kundër meje dhe PMOI vazhduan deri në atë pikë sa që, në mënyrë që të bisedonin personalisht me mua dhe të më çonin në Kanada, një delegacion nga qeveria kanadeze erdhi disa herë në Kampin Ashraf në Irak. Çdo herë, në takimet e mia private me delegacionin e qeverisë kanadeze, u kam shpjeguar atyre se qëndroja me PMOI me vullnetin tim të singertë.

Pasi nuk kisha më asnjë dyshim se Mostafa Mohammadi, pa asnjë dashuri familjare, po më keqpërdorte si një mjet për të fituar para dhe për të realizuar misionet e MOIS kundër PMOI, unë i ndërpova të gjitha lidhjet dhe takimet me të përgjithmonë.

Për informacionin tuaj, prania e këtyre agjentëve të MOIS së regjimit iranian rreth Kampit Ashraf nën maskën e familjarëve hapi rrugën për sulmet gjakatare dhe masakrat në Kampin Ashraf. Ata përdorën 320 altoparantë të fuqishëm për të kumbuar slogane kundër nesh gjithë ditën, dhe në këtë mënyrë na vinin nën një torturë psikologjike. Ata, gjithashtu, i nxisnin agjentët iranianë të sulmimit Kampin Ashraf. Mostafa Mohammadi ishte gjithmonë i pranishëm në

këtë torturë psikologjike kundër banorëve të Ashraf, dhe ishte në krye të saj, sipas fjalëve që agjentët e tjerë thoshin përmes altoparantëve.


Kam bashkëngjitur faqet e pasaportës kanadeze të Mostafa Mohammadi-t, përmes së cilës ai udhëtoi në Irak. Ndërkohë që ai është shtetas kanadez, dhe duhet të kishte marrë një vizë në Kanada, mund të shihni se vizat janë lëshuar të gjitha në Iran, gjë që tregon se prania e tij në Irak ishte për komplete të sponsorizuara nga regjimi iranian.

E kam publikuar të gjithë historinë time dhe përpjekjet e Mostafa Mohammadi-t për të abuzuar me mua, që legjitimizuan vrasjet e banorëve të Ashraf dhe Liberty nga regjimi iranian, në një libër të titulluar "Fundi i një Komploti", i cili është publikuar në faqe të ndryshme interneti. Libri në përfundim të tij në anglisht mund të shkarkohet, mes të tjerash, në URL-të e mëposhtme:


Prania e Mostafa Mohammadi-t në Shqipëri është shumë shqetësuese për mua. Nuk jam e shqetësuar për veten, por për sigurinë e miqve të mi në Shqipëri. Prania e tij tregon se regjimi iranian po kërkon të bëjë komplete të tjera djallëzore kundër nesh në Shqipëri. Nuk kam asnjë dyshim se ky regjim, ashtu si në të shkuarën, do të drejtojë fushata demonizuese të tilla si "PMOI nuk më lejon të takohem me Mostafa Mohammadi-n", apo "Unë, 38 vjeçe, jam në PMOI kundër vullnetit tim" në mënyrë që të hapë rrugën për të goditur sigurinë tonë dhe të shkelë të drejtën tonë për të jetuar.

Prandaj, duke marrë parasysh se qëllimi i regjimit për të realizuar një operacion terrorist kundër PMOI në Paris, dhe arrestimi i agjentëve të tij, duke përfshirë një diplomat, u ekspozua javën e shkuar, do të doja t'u kërkoja t'u pengonit rrugën masive të mëtejshme të regjimit iranian duke e përfshirë Mostafa Mohammadi-n nga Shqipëria.

Me respekt,  
Somayeh Mohammadi



**Fjalëkryqi (1)**



- 36. Një pjesë e dimensioneve.
- 39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- 41. Kalimi në ekstreme.
- 42. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
- 44. Si i gjithë .
- 47. Kush e thotë lutet.
- 48. Kufij elementi.
- 49. Ishte nryja që preu Alekdansdri i Madh.
- 50. Një pjesë e titanëve.
- 51. Mund të jetë kundërmuese.
- 52. Pak titanike.

- VERTIKAL**
- 1. Si i përshtatëshëm.
  - 2. Mund të jenë fetare.
  - 3. Ai i kuq e ka një huq.
  - 4. Pak analogji.
  - 6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
  - 7. Në hyrje të oazit.

- HORIZONTAL**
- 1. Mund të jetë kursimi.
  - 5. Ylli i Nostradamus.
  - 8. Tamam pa kufij.
  - 11. Ross këngëtare.
  - 13. I lashtë.
  - 15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
  - 19. Kufijtë e lëvizjes
  - 20. I ka tek plepi.
  - 21. Paguhen për shërbim.
  - 23. Fillojnë lejen.
  - 24. Kufizojnë trotualet.
  - 25. Bëjnë karrierë në parti.
  - 27. Thahet me bonifikim.
  - 28. Mund të jetë unik një i tillë .
  - 29. Preka komik shkordran.
  - 31. Fund dhjetori.
  - 32. Fillojnë aksionin.
  - 33. Ente Operative Tiranë
  - 34. Agjenci Ajrore Durrës.


- 8. Arte pa re.
- 9. Arthur që qe dramaturg.
- 10. Janë boshte.
- 12. Michelangelo regjisor.
- 14. Mund të bëjë stil të lirë .
- 16. Ishin monedhe të Tobias.
- 17. Eshhtë bas me katër tela.
- 18. Pak efikasitet.
- 22. Eshhtë marrëveshje me nota.
- 25. Ishte babai i Akillit.
- 26. Fillojnë nazet.
- 27. Në krye të kuadrove.
- 29. Eshhtë faqe muri.
- 30. Një apendisit i menjëhershëm.
- 35. Kurosawa që qe regjisor.
- 36. Vriten nga espada.
- 37. Eshhtë shtet aziatik.
- 38. Edouard piktor.
- 40. Një transporti është kamioni.
- 45. Uni i Freud.
- 46. Një cigan.
- 47. Fundi i një samurai.

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL**
- 1. Fillojnë panikun.
  - 3. Gibson aktor.
  - 5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
  - 9. Mund të jetë trofe.
  - 11. Janë vendet si Katari
  - 14. Maureen që qe aktore.
  - 16. Janë kundërmuese.
  - 17. Mund të fitojnë etapa.
  - 20. Ushtojnë nga "ola".
  - 22. Një thirrje
  - 26. Janë ministritë.
  - 27. Një rrugë në Paris.
  - 28. Markë cigareje.
  - 29. Eshhtë ngjinja.
  - 32. Ricciarelli soprano.
  - 33. Fillojnë sefte.
  - 34. Ente Ekonomike Sarandë.


- 35. Mbyllin një ditar.
- 36. Sateliti i Jupiterit
- 37. I ka tek Luani.
- 38. Bolidi komik italian.
- 42. Eshhtë kolana në filma
- 43. Kush e thotë lutet.
- 44. Oxa këngëtare.
- 46. Inicialet e Nolte aktor.
- 47. Eshhtë tokë që... fitohet.
- 48. Një... gjermane.

- VERTIKAL**
- 1. Një votë në favor.
  - 2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
  - 3. Në hyrje makinës.
  - 4. Fillojnë lehtë.
  - 5. Irlanda në Dublin.
  - 6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
  - 7. Një pjesë e gamiljeve
  - 8. Notat pa kufij.
  - 9. Ishin komitë.
  - 10. Ka kryeqytet Islamabad.
  - 12. Don... i Interpretuar nga Terence
  - 13. Mbyllin aktet.
  - 15. Janë përmasa.
  - 18. Gjysma e lujes.
  - 19. Castellitto aktor.
  - 20. Inicialit e Dalí, piktor.
  - 21. Tanita këngëtare.
  - 23. Eshhtë tryzni
  - 24. Në hyrje të Europës.
  - 25. Janë rrobat për t' u larë.
  - 30. Bën mëza.
  - 31. Moreau aktore.
  - 32. Janë thika.
  - 39. Një pjesë e satelitit.
  - 40. Janë teke në sende.
  - 41. Pak marramendëse.
  - 42. I ka tek zdapi.
  - 45. Inicialet e Nolte-s.




- 6. Notat pa kufij.
- 9. Ishin komitë.
- 10. Ka kryeqytet Islamabad.
- 12. Don... i Interpretuar nga Terence
- 13. Mbyllin aktet.
- 15. Janë përmasa.
- 18. Gjysma e lujes.
- 19. Castellitto aktor.
- 20. Inicialit e Dalí, piktor.
- 21. Tanita këngëtare.
- 23. Eshhtë tryzni
- 24. Në hyrje të Europës.
- 25. Janë rrobat për t' u larë.
- 30. Bën mëza.
- 31. Moreau aktore.
- 32. Janë thika.
- 39. Një pjesë e satelitit.
- 40. Janë teke në sende.
- 41. Pak marramendëse.
- 42. I ka tek zdapi.
- 45. Inicialet e Nolte-s.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

				6			
8			1	5		4	
3		5		2		8	1
9				1			8
	6	7			4		
1	4					3	
	7			5	8		2
		9	2				
	3						1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	1	9	6	8	3	2	7	4
4	6	2	7	5	9	3	8	1
7	8	3	1	4	2	6	9	5
2	3	5	9	6	7	1	4	8
6	7	8	2	1	4	5	3	9
9	4	1	5	3	8	7	6	2
3	5	6	4	9	1	8	2	7
1	2	4	8	7	6	9	5	3
8	9	7	3	2	5	4	1	6

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

S	A	R	A	B	A	D	P	L	A		
A	D	D	E	S	I	D	E	R	I	U	S
T	E	B	U	R	I	D	A	N	I	I	K
R	R	A	H	A	R	A	K	I	R	I	V
A	E	S	A	T	E	S	I	J	V	I	T
P	I	T	O	N	I	H	D	A	N	A	E
H	A	S	I	M	U	R	I	A	L	T	
S	U	S	P	A	R	I	D	I	L		
A	I	F	A	R	I	S	E	J	T	E	
G	J	A	K	U	Y	P	R	E			
K	R	I	N	A	P	R	O	T	E	U	
T	O	E	D	I	T	H	S	A			

**FJALËKRYQI (1)**

C	L	A	U	D	E	K	N	G	O	L	
S	A	G	A	N	G	A	N	I	M	E	D
O	K	A	M	I	N	T	A	R			
L	A	R	P	A	G	A	N	I	N	A	R
O	K	A	K	L	A	S	I	G	M	A	R
K	E	F	A	K	U	V	E	T	M		
A	R	O	S	A	K	T	E				
L	O	B	T	N	R	T	E	A			
N	I	C	O	T	A	H	E	R	O	I	
S	T	A	U	I	P	O	N	K			
P	I	S	T	A	M	O	S	T	I	E	
Y	A	R	D	E	M	E	T	R	A		

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

- Ndonjëherë jeta i ndan dy njerëz vetëm për të treguar se sa të rëndësishëm janë ata për njëri-tjetrin.

- Ajo që ndodh një herë, nuk mund të ndodhë përsëri. Por ajo që ndodh dy herë, patjetër do të ndodhi dhe për së treti.

- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.

- Nëse dashuria transformon një person me shpejtësi, dëshpërimi e bën atë edhe më shpejt.

**KRIPTOSKEME**

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5		
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	
8	2	6	2	2	2	1	8	5	11	1		
1	6	8		17	9	5	7	2		9		
3	1	5		8	2	16			2	7	1	
2			3	2	6	5	9	2		1	13	
6	2	7	2			5		7	18	3	6	T
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

K	A	F	E			T	A	L	E	N	T			
A	D	A	M			P	A	F	T	E	R			
T	E	T				H	E	P	A	T	I	T	I	
E	T					H	E	R	E	T	I	K	E	
G						K	O	M	I	T	E	T	E	T
O						E	K	I	P	E	T	T	F	
R	I	K				N	E	T	T	A	P	A		
I						O	G	C		S	T	I	L	
K	P					S	W	I	N	G		S	L	
E	O					P	A	T	E	N	T	A	T	
N	A					Y	E			U	R	A	T	
T	Y	M	I			P	I	R	A	T	I			

*Thënie të mençura*

- - Sapo kam gjetur të gjitha përgjigjet, menjëherë ndryshuan të gjitha pyetjet.
- - Gjithmonë të shprehni atë që ndjeni dhe të bëni atë që mendoni! Heshnja shkatërron jetën...
- - Tri gjëra e karakterizojnë njeriun e mençur: Së pari, bën ato që këshillon të tjerët të bëjnë. Së dyti, nuk bën asgjë që është në kundërshtim me të vërtetën. Së treti, është i durueshëm me dobësitë e të tjerëve.

